

PROJEKT RREGULLORE PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË PORTABILITETIT TË NUMRIT **Dokument për Këshillim Publik¹**

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.7, datë 12.06.2025)

¹ Shpjegime dhe sqarime në lidhje me dokumentin, procesin dhe pyetjet e këshillimit publik për palët e interesuara janë dhënë në Shtojcën 1, në fund të dokumentit të Projekt Rregullores.

Ndryshimet kryesore të kësaj Projekt-Rregulloreje nga rregullorja aktuale, Rregullore nr.43/2016 “Për Zbatimin e Portabilitetit të Numrit” e ndryshuar (në vijim, Rregullorja 43/2016), janë dhënë me tekst në ngjyrë të theksuar (**bold**) dhe nënvizuar (underlined)

KAPITULLI I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është:

- a) përcaktimi i mënyrës së zbatimit të portabilitetit të numrit nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike;
- b) përcaktimi i afateve kohore përkatëse për zbatimin e portabilitetit;

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i Rregullores është garantimi i zbatimit të portabilitetit të numrit nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike dhe/ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun (**shërbimi i komunikimit zanor**), në përputhje me zgjidhjet teknike, mënyrën dhe afatet e përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo Rregullore hartohet në zbatim të **Nenit 12, pikat 1/j dhe 2/l, dhe Neneve 126, 145 dhe 146 të Ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (në vijim, Ligji 54/2024).**

Neni 4

Përkufizime dhe Shkurtime

Përveç sa parashikohet nga **Ligji 54/2024, dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij**, për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Portabilitet i Numrit” është shërbimi/faciliteti nëpërmjet të cilit përdoruesit fundorë/pajtimtarët të pajisur me numra nga Plani Kombëtar i Numeracionit mund të mbajnë numrat e tyre, sipas kërkesës, pavarësisht nga sipërmarrësi që i ofron shërbimin pajtimtarit në pikën fundore të rrjetit.**
2. “Baza e të dhënave referencë të centralizuar (CRDB)” është Baza Qendrore e të Dhënave Centralizuar për portabilitetin e numrit, e cila regjistron statusin e çdo **transaksioni** dhe të gjitha mesazheve standarde të shkëmbyera midis operatorëve gjatë procesit të bartjes së numrit, si edhe përmban informacionin (të dhënat) e nevojshëm për rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të bartur, **me anë të së cilit përditësohen** bazat e të dhënave lokale pasqyre (LBPS) të numrave të bartur **të të gjithë operatorëve.**
2/1 “Operatori i bazës së të dhënave referencë të centralizuar” (në vijim, Operatori i CRDB) është personi juridik i cili është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i zgjedhur nga AKEP sipas procedurave përkatëse të prokurimit publik për të siguruar mirëmbajtjen dhe menaxhimin e funksionimit të platformës (hardëare) dhe sistemeve të programuara (softëare) të instaluar në bazën e të dhënave referencë të

centralizuar (CRDB), në përputhje me përcaktimet në këtë Rregullore dhe aktet e tjera përkatëse të AKEP të lidhura me portabilitetin e numrit.

3. **“Baza e të dhënave lokale pasqyre (LBPS)” është një bazë aktive të dhënash e vendosur tek operatori, që përmban të dhënat e nevojshme për rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të bartur dhe që përdoret në kohë reale nga operatori gjatë vendosjes së një thirrje.**
4. **“Metoda All Call Query (ACQ)” është metodë rrugëzimi drejt numrave të bartur të çdo thirrje që përcakton se rrjeti origjinues, para vendosjes së çdo thirrje, përcakton rrjetin në të cilin numri i thirrur është i vendosur aktualisht duke kërkuar në bazën e të dhënave lokale pasqyre (LBPS) të vetën.**
5. **“Operator/ofrues i komunikimeve elektronike publike” (në vijim Operator) është një sipërmarrës që është i autorizuar të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike publike, përfshirë rrjete dhe/ose shërbime publike telefonike/të komunikimit zanor sipas përcaktimeve të ligjit 54/2024 dhe akteve nënligjore përkatëse.**

5/1 “Operator i rrjetit të aksesit” është një sipërmarrës/operator, rrjeti i aksesit apo facilitetet shoqëruese të së cilit përdoren nga operatori/ofruesi dhënës apo operatori/ofruesi marrës ose nga të dy bashkë për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra (shërbim publik telefonik/shërbim komunikimi zanor) për përdoruesin fundor/pajtimtarin.
6. **“Operator/Ofrues Dhënës” (në vijim Operator Dhënës/ODH) është Operatori që ofron shërbimin publik telefonik/komunikimin zanor pajtimtarit para portimit të numrit.**

Shënim: Termi Operator Dhënës në këtë Rregullore ka të njëjtin kuptim si termat Ofruesi Tranferrues, Sipërmarrësi Transferrues dhe Ofruesi Dhënës të referuar në pikat 12, 14 dhe 15 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024, dhe

6/1 “Rrjeti dhënës” (në vijim referuar dhe si rrjeti i ODH): rrjeti i komunikimeve elektronike publike, i ODH ose i përdorur nga ODH, në të cilin ishte/është i vendosur numri para portimit.

6/2 “Operator Dhënës Fillestar” (në vijim, ODHF) është operatori të cilit AKEP i ka caktuar të drejtën e përdorimit të numrave apo serisë numerike ku bën pjesë një numër i bartur. Në rastin kur një numër është portuar vetëm njëherë apo është në proces të portimit për herë të parë, ODH dhe ODHF është i njëjti sipërmarrës.
7. **“Operator/Ofrues Marrës” (në vijim Operator Marrës/OM) është sipërmarrësi që ofron shërbimin publik telefonik/komunikimi zanor pajtimtarit pas portimit të numrit.**

Shënim: Termi Operator Marrës në këtë Rregullore ka të njëjtin kuptim si termi Ofruesi Marrës i referuar në pikat 12 dhe 14 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024.

7/1 “Rrjeti marrës” (në vijim rrjeti i OM): rrjeti i komunikimeve elektronike publike, i OM ose i përdorur nga OM, në të cilin vendoset numri pas bartjes.
8. **“Bartja/portimi i numrit” është transferimi i numrit të pajtimtarit nga ODH drejt OM, përfshirë proceset e çaktivizimit të numrit nga rrjeti i ODH dhe aktivizimit të tij në rrjetin e OM.**

9. “Operatori i bazës së të dhënave reference të centralizuar” (në vijim, Operatori i CRDB) nënkupton një subjekt (person juridik), i cili mirëmban dhe menaxhon funksionimin e platformës dhe sistemeve të operimit të instaluar në CRDB sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore.
10. “Pajtimtar” është përdoruesi fundor, konsumator ose biznes apo cdo lloj entiteti, që ka lidhur një kontratë (me plan tarifor parapagesë, paspagesë apo hibrid) me një sipërmarrës që përfshin ofrimin e shërbimit publik telefonik/shërbimit të komunikimit zanor.
11. “MSISDN” është një numër kombëtar N(S)N unik, i cili identifikon pajtimtarin në një rrjet të komunikimit të lëvizshëm (numri telefonik i lëvizshëm).
12. “Numër Aktiv” në kuptimin e kësaj Rregulloreje është një numër nga Plani Kombëtar i Numeracionit i dhënë nga sipërmarrësi në përdorim të një pajtimtari/përdoruesi fundor, i cili ndodhet në kushtet e një kontratë pajtimi aktive/të vlefshme (me mënyrë pagese me parapagim ose paspagim, me afat të caktuar ose të pacaktuar) me Ofruesin e shërbimit të komunikimit zanor (ODH), pra ka të aktivizuar shërbimin publik telefonik/komunikimit zanor. Kontrata/numri konsiderohet aktive dhe nëse pajtimtarit i janë pezulluar/çaktivizuar përkohësisht (por jo përfundimisht) shërbimet (p.sh për shkak të vonesave në pagesa, moskryerje rimbushje/skadin i afateve të krediteve me parapagim). Një numër celular me parapagim quhet aktiv në kuptim të kësaj Rregulloreje për sa kohë është në gjendje të dërgojë dhe/ose marrë komunikime në kohën e kërkesës për portim, dhe nuk ka kaluar në statusin e numrit të çaktivizuar nga ofruesi i shërbimit.
13. “Numër i Çaktivizuar” në kuptimin e kësaj Rregulloreje është një numër i cili nuk ndodhet më në kushtet e një kontrate aktive/të vlefshme sipas përkufizimit të pikës 12 më sipër, pasi kontrata e pajtimit është përfunduar nga pajtimtari dhe/ose ofruesi i shërbimit të komunikimit zanor, dhe numri është çaktivizuar përfundimisht nga rrjeti i ODH.
14. “Numri Personal i Identifikimit” - Është numri unik personal në Kartën e Identitetit, Pasaportën, e cdo shtetasi Shqiptar ose të huaj me banim të përhershëm ose përkohshëm në Republikën e Shqipërisë dhe që shërben si kriteri kryesor i identifikimit të pajtimtarit.
15. “Miratimi”: tërësia e verifikimeve nga ODH për të kontrolluar saktësinë dhe plotësinë e kërkesës së dërguar nga OM me qëllim shmangien e gabimeve në ekzekutimin e portabilitetit të numrit.
16. “Refuzim”: refuzim i kërkesës për portim të numrit nga ODH në bazë të kritereve të refuzimit të përcaktuara në këtë Rregullore.
17. “Miratim/pranim me kusht”: është është përgjigja e ODH për kërkesën për portim të një numri me plan tarifor me paspagim në rastet se nga procesi i verifikimit rezulton se pajtimtari është debitor apo ka detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës ekzistuese me ODH për numrin që do të bartet (sipas pikës 19 më poshtë).
18. “Status pezull”: është statusi i krijuar në sistemin CRDB për një kërkesë për portim për një numër celular ose fiks e cila është miratuar me kusht nga ODH.
19. “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”: janë detyrimet financiare të pajtimtarit ndaj ODH, pagesa/përmbushja e të cilave është e nevojshme të kryhet përpara miratimit të kërkesës për portim të numrit nga ODH, të cilat mund të përfshijnë sipas rastit:

- a. Detyrime për faturat e lëshuara nga ODH (përfshirë detyrimet e prapambetura të mundshme - që u ka kaluar afati i pagesës - dhe faturën e muajit aktual/mëparshëm) dhe të papaguara nga pajtimtari deri në datën e marrjes së kërkesës për bartje nga ODH nëpërmjet CRDB/datën e pranimi me kusht të kërkesës;
 - b. Detyrimi për përdorimin e shërbimit gjatë muajit aktual sipas faturës të lëshuar/që mund të lëshohet nga ODH deri në datën e njoftimit të pranimi me kusht të kërkesës për portim ose në datën e pagesës nga pajtimtari së detyrimeve të referuara në këtë paragraf (pikat a dhe c);
 - c. Penalitete¹ dhe/ose kompensime financiare² te aplikueshme për pajtimtarin në rast të përfundimit para afatit minimal të kontratës me afat të caktuar sipas përcaktimeve të nenit 144 të Ligjit 54/2024.
20. “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”: janë detyrimet që mund të përmbushen nga pajtimtari vetëm në datën e përfundimit të kontratës ose pas kësaj date, dhe të cilat mund të përfshijnë sipas rastit:
- a. Detyrimi për pagesën e faturës së lëshuar nga ODH për tarifimin e aplikueshëm për marrjen/përdorimin e shërbimit pas datës së fundit të periudhës së faturuar deri në datën e realizimit të portimit të numrit/ndërprerjes së shërbimit nga ODH/, nëse shërbimet e përfituara nga pajtimtari gjatë kësaj periudhe nuk janë ose janë pjesërisht të përfshira në faturën e fundit të lëshuar nga ODH (pika 19/a ose 19/b më sipër);
 - b. Kthimi i pajisjes fundore të përfshirë në paketën tarifore të integruar ose kompensimi për pajisjen në rast të moskthimit të saj brenda afatit të caktuar nga ODH sipas kontratës ekzistuese (jo më herët se data e ndërprerjes së shërbimit nga ODH).

Neni 5

Fusha e zbatimit dhe parime të përgjithshme

1. Kjo Rregullore zbatohet vetëm për portabilitetin e numrave të caktuar përdoruesve fundorë/pajtimtarëve nga sipërmarrësit për përdorim për shërbim publik telefonik/komunikim zanor që i përkasin kategorive të mëposhtëme të numrave në PKN:
 - numra gjeografikë (në vijim numra fiks) sipas përkufizimit në pikën 25 të Nenit 4 të Ligjit 54/2024;
 - numra jogjeografikë të lëvizshëm (në vijim numra të lëvizshëm) sipas përkufizimit në pikën 26/a të Nenit 4 të Ligjit 54/2024.
2. Portabiliteti i numrave fiks zbatohet vetëm midis ODH dhe OM të cilët janë ofrues të shërbimit publik telefonik/komunikimit zanor nga vendndodhje fikse dhe një numër fiks mund të bartet/aktivizohet vetëm në rrjete që ofrojnë shërbim publik telefonik/komunikim zanor nga vendndodhje fikse (rrjetet publike telefonik fiks) dhe në një vendndodhje të caktuar gjeografike, që i përket të njëjtit rajon gjeografik/zone numeracioni si para bartjes, në përputhje me Planin Kombëtar te

¹ Penalitet/tarifë për zgjidhje të parakohshme të kontratës me afat të caktuar sipas pikës 1/c/iv të Nenit 180 të Ligjit 54/2024 (pika 2 e Nenit 18 të Rregullores 49/2021). Ky penalitet nuk është i aplikueshëm në rastet e parashikuara në pikat 6, 8, 9 dhe 10 dhe 11, të nenit 144 të ligjit 54/2024.

² Kompensim për pajisje fundore: Detyrimet e mbetura për pajisjet fundore të subvencionuara/ të përfshira në paketën tarifore të integruar, në momentin e lidhjes së kontratës (sipas pikave 11 dhe 12 të Nenit 144 të Ligjit 54/2024).

Numeracionit dhe Rregulloren përkatëse të AKEP³ për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit.

3. **Portabiliteti i numrave të levizshëm zbatohet vetëm midis ODH dhe OM të cilët janë ofrues të shërbimit publik telefonik/komunikimit zanor të levizshëm dhe një numër i levizshëm mund të bartet/aktivizohet vetëm në rrjete të levizshme, pavarësisht vendndodhjes.**
4. **Portimi/portabiliteti i numrave nuk zbatohet për bartjen e numrave midis rrjeteve që ofrojnë shërbime nga vendndodhje fikse dhe rrjeteve të levizshme.**
5. Portabiliteti i numrit ndjek parimin e neutralitetit të teknologjisë. Nuk kërkohet që Operatori Dhënës dhe Operatori Marrës të përdorin teknologjinë e njëjtë për të ofruar shërbime publike telefonike/**shërbime të komunikimit zanor për pajtimtarin, pra pavarësisht teknologjisë së komutimit të thirrjeve (circuit sëitching or packet sëitching).**
Një numër fiks mund të bartet pavarësisht teknologjisë së rrjetit fiks (p.sh fibër optike, kabëll koaksial, tela bakri etj.) të përdorur nga OM dhe/ose ODH.
Një numër i levizshëm mund të bartet pavarësisht teknologjisë së rrjetit të levizshëm (2G; 3G; 4G; 5G etj) apo teknologjisë së kartës SIM (kartë fizike SIM apo eSIM) të përdorur nga OM dhe/ose ODH.
6. **ODH ka detyrim të pranojë/miratojë kërkesë për portim vetëm për numrat për të cilët pajtimtari/përdoruesi fundor ka të drejtë të kërkojë portimin e tyre, sipas përcaktimeve në këtë Rregullore.**
7. Aplikimi teknik i portabilitetit të numrit nuk parandalon zgjerimin e mëvonshëm të fushëveprimit të dispozitave **nën**-ligjore për portabilitetin e numrit. Baza e të dhënave referencë e centralizuar do të mund të mbështesë bartjen e të gjithë numrave të planit kombëtar të numeracionit, sipas akteve **përkatëse** të AKEP.
8. **Përcaktimet e kësaj Rregulloreje në lidhje me rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të portuar zbatohen nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve komunikimeve elektronike që ofrojnë shërbime të komunikimit zanor për pajtimtarët e tyre si dhe operatorët e rrjeteve që kryejnë tranzitim të thirrjeve, në përputhje me përcaktimet në Nenin 8 të kësaj Rregulloreje dhe akteve të tjera nënligjore të AKEP.**

KAPITULLI II

Zgjidhjet teknike të portabilitetit të numrit dhe sigurimi i disponueshmërisë së CRDB

Neni 6

Detyrimet për përgatitjen e rrjetit të OM/ODH dhe testimet

1. Të gjithë operatorët janë të detyruar të përshtatin dhe përmirësojnë rrjetet **dhe sistemet e tyre të komunikimit elektronik në linjë me rritjen e sasisë së numrave të bartur, në mënyrë që ato të mundësojnë portabilitetin e numrit dhe zbatimin e detyrimeve përkatëse për portabilitetin e numrit si ODH dhe OM sipas përcaktimeve të Ligjit 54/2024 dhe kësaj Rregulloreje.**

³ Aktualisht: Rregullore Nr.10, për “Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 932 datë 11.08.2009, e ndryshuar.

2. Të gjithë operatorët duhet të krijojnë një bazë të dhënash lokale pasqyre të numrave të bartur (LBPS) duke përfshirë informacionin e të gjithë numrave të bartur në Republikën e Shqipërisë.
3. Të gjithë operatorët, lidhur me procesin e bartjes së numrit, janë të detyruar të shkëmbejnë në mënyrë të ndërsjellët informacionin, mbi përdorimin e numrave të bartur, në CRDB, e cila regjistron të gjitha statet e bartjes së numrave.
4. Komunikimi midis Operatorëve Marres dhe Dhënës për bartjen e numrave realizohet vetëm nëpërmjet CRDB.
5. **OM dhe ODH janë përgjegjës për procesin e transferimit të numrit dhe për përgatitjen e rrjetit, sistemeve dhe shërbimeve të tyre të komunikimeve elektronike, ku cilësia e shërbimit ekzistues nuk duhet të cenohet gjatë procesit të transferimit të numrit.**
6. **Në mënyrë që të ofrojë/mudësojë shërbimin e portabilitetit të numrit, operatori është i detyruar të vendosë dhe testojë interkoneksionin me operatorët e tjerë përpara se të ofrojë shërbimin e portabilitetit të numrit.**
7. **Para ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit, operatorët janë të detyruar të kryejnë të paktën testet e mëposhtme:⁴**
 - a) **lidhjen ndërmjet operatorit dhe CRDB sipas udhëzimeve të operatorit të CRDB, përfshirë për procesin e portimit të numrit ndërmjet operatorit dhe CRDB, marrjen e njoftimeve për statusin e procesit të portimit dhe përditësimin e LBPS**
 - b) **interkoneksionin me operatorë të tjerë si ODH dhe OM për origjinimin, terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve, mesazheve SMS dhe MMS (operatorët rrrjeteve të lëvizshme) drejt/nga numra të portuar përfshirë shfaqjen korrekte të CLI.**

Neni 7

Informacioni mbi numrat e bartur

1. Informacioni rreth numrave të bartur ruhet në bazën e të dhënave lokale pasqyre të numrave të bartur (LBPS) të operatorëve dhe në CRDB, e cila është një bazë të dhënash referuese.
2. CRDB ofron informacion për çdo numër të bartur, në rrjetin në të cilin numri i bartur ka qenë i vendosur para bartjes, në rrjetin në të cilin numri vendoset pas bartjes si për datën dhe orën e saktë kur bartja do të bëhet efektive. Të gjithë operatorët të cilët rrugëzojnë thirrje tek numrat fiks dhe të lëvizshëm do të sinkronizojnë bazën e të dhënave lokale pasqyre me bazën e të dhënave referencë të centralizuar së paku çdo gjashtë orë.

Neni 8

Rrugëzimi i thirrjeve drejt numrave të bartur

1. Operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun/**shërbimeve të komunikimit zanor** nëpërmjet automatizimit të plotë të procesit duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të bartur fiks dhe të

⁴ Testimet kryhen sipas udhëzimeve të operatorit të CRDB dhe dokumentit të specifikimeve teknike për portabilitetin e numrit të AKEP.

lëvizshëm. Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “All Call Query”(kërkimi për çdo thirrje).

2. Operatori i rrjetit dhe shërbimeve të lëvizshme, në të cilën origjinohet thirrja, është përgjegjës për rrugëzimin e thirrjes (transferim direkt), ose dërgimin e mesazheve drejtuar numrave të bartur në të gjitha rrjetet, në të cilat numrat e bartur janë vendosur, në përputhje me specifikimet teknike të standardit ETSI TS 123 066.
3. Operatorët e komunikimeve elektronike të shërbimeve publike të telefonisë/**komunikimit zanor** fikse, si dhe operatorët që tranzitojnë thirrjet midis rrjeteve, janë përgjegjës për rrugëzimin e duhur direkt të thirrjeve në numrat e bartur të rrjeteve të tjera fikse duke përdorur metodën "All Call Query – kërkimi për çdo thirrje".
4. Operatorët e komunikimeve elektronike të shërbimeve publike të telefonisë/**komunikimit zanor** se levizshme, në rrjetin e të cilit gjenerohen thirrjet dhe operatorët të cilët rrugezojnë thirrje nga rrjete të tjera, janë direkt përgjegjës për rrugëzimin e duhur të thirrjeve në numrat e bartur në rrjetet e komunikimeve elektronike publike të lëvizshme sipas metodës "All Call Query - kërkimi për çdo thirrje".
5. Për rrugëzimin e thirrjeve/mesazheve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar, operatori i parë i autorizuar në RSH që merr thirrjen/mesazhin hyrës ndërkombëtar në marrëdhënie direkte me operatorë të huaj ka detyrimin e përcjelljes së tyre në rrjetin e duhur ku ndodhet aktualisht numri i portuar, sipas rasteve të mëposhtëme:
 - a. Sipas metodës "All Call Query – kërkimi për çdo thirrje": përcjellje direkte tek operatori marrës (rrjeti ku ndodhet aktualisht numri) në rastet kur dy operatorët kanë lidhur marrëveshje interkoneksioni, që përfshin dhe përcjelljen e thirrjeve/mesazheve hyrëse ndërkombëtare midis këtyre dy operatorëve për numrat e portuar. Kjo metodë aplikohet edhe kur operatori i parë që merr thirrjen/mesazhin hyrës ndërkombëtar është operatori dhënës fillestar i numrit;
 - b. Sipas metodës "Onëard Routing": operatori i parë që merr thirrjen mesazhin ndërkombëtar përcjell thirrje/mesazhin në rrjetin e operatorit dhënës fillestar të numrit (mbajtës i numrit të alokuar nga AKEP), me të cilin ka marrëveshje interkoneksioni për terminim thirrje/mesazhe hyrëse ndërkombëtare, dhe më pas operatori dhënës ka detyrimin të përcjellë thirrjen/mesazhin tek operatori marrës i numrit (ku ndodhet aktualisht numri) sipas përcaktimeve të marrëveshjes përkatëse të interkoneksionit me operatorin marrës. Kjo metodë aplikohet në rastet kur operatori i parë që merr thirrjen/mesazhin ndërkombëtar ka marrëveshje interkoneksioni me operatorin dhënës fillestar të numrit për terminim thirrje/mesazhe hyërse ndërkombëtare drejt këtij operatori por nuk ka marrëveshje të tillë me operatorin marrës të numrit.

Operatori dhënës fillestar ka detyrimin të paguajë operatorin marrës tarifën përkatëse të terminimit të komunikuar nga ky i fundit, dhe ka të drejtë të tarifojë operatorin që i përcjell thirrjen/mesazhin ndërkombëtar tarifën e terminimit të operatorit marrës për këto thirrje/mesazhe dhe një tarifë për shërbimin e kërkimit në databazë dhe tranzitimit të thirrjes drejt rrjetit të operatorit marrës ku ndodhet aktualisht numri. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis operatorit dhënës dhe marrës për tarifën e terminimit të thirrjeve/mesazheve hyërse ndërkombëtare drejt numrave të portuar (përfshirë për rastet e pikës (a) më sipër) zgjidhen nga AKEP sipas përcaktimeve në **nenin 47 të Ligjit 54/2024.**
6. Operatorët mund të përmbushin detyrimet e vendosura në kete nen vetë ose nëpërmjet

marrëveshjeve kontraktore me një operator tranzitues, një kopje e të cilës depozitohet në AKEP.

Neni 9

Njoftimi i numrit të bartur

1. Operatorët janë të detyruar t'i njoftojnë nëpërmjet një mesazhi zanor në formën beep tone, pajtimtarëve të tyre, bartjen e numrit, përpara kryerjes së thirrjes drejt numrave të bartur.
2. Beep tone do të jetë i njëjtë për të gjithë operatorët e do të shërbejë për të njoftuar pajtimtarët se numri është bartur.

Neni 10

Baza e të dhënave referencë të centralizuar (CRDB)

1. Për shkëmbimin e të dhënave mbi numrat e bartur ndërmjet bazave lokale pasqyre të të dhënave të numrave të bartur (LBPS) përdoret baza e të dhënave referencë të centralizuar (CRDB)
2. CRDB përmban **informacion për** të gjithë numrat e bartur, përfshirë kodet për rrugëzimin e thirrjeve në numrat e bartur dhe transaksionet midis operatorëve (operatorët, emrat e dhuruesve dhe numrin e operatorëve Marrës të numrave, datat, numri i transfertave, informacion mbi statusin e procesit të bartjes së numrave).
3. **AKEP siguron disponueshmërinë e CRDB nëpërmjet kryerjes së procedurave përkatëse të prokurimit publik për të garantuar dhe siguruar:**
 - a. **platformën (hardëare) dhe sistemet e operimit (softëare) të CRDB (për herë të parë dhe/ose përmirësime të mëvonshme të nevojshme);**
 - b. **ambientet për hostimin e platformës dhe sistemeve të operimit të CRDB;**
 - c. **shërbimin e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të funksionimit të platformës dhe sistemeve të instaluar në CRDB, që kryhet nga Operatori i CRDB.**
4. **Për të siguruar disponueshmërinë e vazhdueshme, sa më cilësore dhe të besueshme të CRDB, përfshirë funksionimin e CRDB, AKEP kryen në mënyrë periodike (jo më pak se një herë në tre vjet) procese këshillimi publik me palët e interesuara,**
5. **Procesi i këshillimit publik i referuar në pikën 4 më sipër, përfshin diskutim me palët e interesuara në lidhje me performancën dhe funksionimin e CRDB, si dhe nevojën, nëse ka të tilla, për përmirësime të platformës dhe sistemeve të instaluar në CRDB dhe çështje të tjera të lidhura me disponueshmërinë e CRDB.**
6. Operatori i CRDB duhet të garantojë, paanshmëri dhe besueshmëri tek **operatorët e komunikimeve elektronike gjatë gjithë periudhës së ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes dhe menaxhimit të funksionimit të platformës dhe sistemeve të instaluar në CRDB.**
Operatori i CRDB duhet të jetë i pavarur nga të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike dhe të ofrojë shërbimin sipas parimit të mosdiskriminimit, pra do të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike të lidhur me CRDB (që kanë detyrim të lidhen me CRDB) si dhe do t'ju bëjë të njohur atyre cdo proces të zhvillimit, përditësimit softurik, teknik apo operacional të lidhur me shërbimin e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të CRDB
Kërkesat teknike, përfshirë ato për garantimin e kriterit të paanshmërisë dhe besueshmërisë, **parimin e mosdiskriminimit**, përcaktohen nga AKEP në dokumentin

“Specifikimet Teknike të Portabilitetit të Numrit” që miratohet me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP⁵ si dhe dokumentet përkatës të specifikimeve teknike/termave të referencës në procedurën e prokurimit publik të përzgjedhjes së Operatorit të CRDB.

7. Operatori i CRDB është përgjegjës për operimin e platformës dhe garanton disponueshmërinë e funksioneve të bazës së të dhënave, **përfshirë zhvillimet e nevojshme softëriake (përfshirë teknike/operacionale) të nevojshme për ndryshimet në procesin e portabilitetit të numrit sipas përcaktimeve në këtë Rregullore dhe aktet e tjera përkatëse të AKEP në lidhje me portabilitetin e numrit.**
8. Specifikimet teknike për ambientin e hostimit të platformës dhe sistemeve të operimit të CRDB përcaktohen nga AKEP në procedurën e prokurimit publik përkatës, nëse hostimi do të kryhet në ambiente të ndryshme nga ato të Operatorit të CRDB.
Pavarësisht paragrafit të mësipërm, dhe pikës 3/b të këtij Neni, për të garantuar dhe siguruar ambientet e hostimit të platformës dhe sistemeve të operimit të CRDB, AKEP mund të përdorë ambientet e veta dhe/ose të institucioneve publike të specializuara që garantojnë hostim të sigurt 24/7 dhe pa kosto shtesë apo me kosto shumë më të ulët se operatorët ekonomikë në treg.
9. Operatori i **CRDB** është i detyruar të zbatojë parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.
10. AKEP bazuar në raportet dhe statistikat e prodhuara nga CRDB do të publikojë periodikisht raporte që përmbajnë informacion dhe statistika për bartjen e numrave, performancën e CRDB dhe operatorëve për portimin e numrave.

Neni 11

Njoftimi paraprak i përdoruesve

1. Në rrjetin origjinues, operatori është i detyruar që t’i përcjellë një “beep tone” thirrësit kur kryen thirrje drejt një numri të bartur, **në rast se tarifa me pakicë për thirrjet/SMS jashtë rrjetit (off-net) janë më të larta se ato brenda rrjetit (on-net)**
2. Operatorët duhet të informojnë pajtimtarët për mundësitë e mësipërme të këtij neni dhe mënyrën e paraqitjes së një kërkesë në përputhje me rekomandimet përkatëse (rekomandime mbi transparencën dhe publikimin e informacionit).
3. AKEP, **nëpërmjet operatorit të CRDB**, ofron një faqe interneti me adresë: www.portabiliteti.al me informacion rreth procesit të bartjes së një numri me qëllim që të interesuarit përveç të tjerash të mund të informohen edhe në lidhje me procesin e portimit të numrit.

Neni 12

Përdorimi i kodeve të rrugëzimit

1. Për transferimin e thirrjeve në numrat e bartur përdoren kodet e rrugëzimit të përcaktuara nga AKEP sipas specifikimeve në Rregulloren përkatëse të AKEP për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit.
2. AKEP me qëllim rrugëzimin e thirrjeve në numrat e bartur të operatorëve është i detyruar

⁵ Dokumenti “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010, do të ndryshohet nga AKEP për të reflektuar të gjitha ndryshimet në portabilitetin e numrit, përfshirë ato të miratuara pas miratimit të versionit final të Projekt-rregullores (në përfundim të këtij procesi këshillimi publik).

- të sigurojë caktimin e kodeve të rrugëzimit të portabilitetit të numrit.
3. Kodi i rrugëzimit në paragrafin e mësipërm përkufizohet si më poshtë: Vlera numerike e Prefiksit të Rrugëzimit për Portabilitetin e Numrit:
99 X₁X₂ ku:
 - a) 99 - kodi i aksesit për portabilitetin e numrit,
 - b) X₁X₂ - është numri identifikues i sipërMarrësit që ofron shërbimin.
 4. Operatori është i detyruar të sigurojë që pajtimtari të mos zgjedhë kodet e rrugëzimit. Çdo përpjekje e tillë duhet të kapet dhe të refuzohet nga sistemi.
 5. Operatorët janë të detyruar të përdorin kodin e rrugëzimit për rrugëzimin e thirrjeve në numrat e bartur.

KAPITULLI III

Procesi i bartjes së numrit

Neni 13

Mundësia e bartjes dhe kërkesa për bartjen e numrit

1. Procesi i bartjes është i bazuar në parimin “one-stop shop”. Një pajtimtar/përdorues fundor i cili dëshiron të bart numrin, bën një kërkesë për mundësinë e bartjes së numrit tek Operatori Marrës.
2. Për të pasur mundësinë e portimit të numrit, përdoruesi fundor duhet të jetë në përdorim të një Numri Aktiv **si pajtimtar i ODH, ose përdoruesi fundor ka përdorur një Numër të Çaktivizuar për të cilin në përfundim të kontratës me ODH nuk ka hequr dorë nga e drejta e portimit të këtij numri, dhe kërkesa për portimin e numrit duhet të kryhet sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në këtë Rregullore.**
3. Procesi për bartjen e numrit udhëhiqet nga Operatori Marrës (recipient-led), pra Operatori Marrës është përgjegjës për dërgimin e kërkesës për portim të pajtimtarit tek Operatori Dhënës, ndjekjen e procesit të bartjes së numrit dhe dërgimin e njoftimeve përkatëse pajtimtarit për procesin sipas përcaktimeve në këtë Rregullore.
4. Formulari i aplikimit për portabilitetin e numrit për përdoruesit fundorë paraqitet bashkëlidhur kësaj Rregulloreje në Aneksin 1.

Neni 14

Detyrimet e Operatorit Marrës

1. Para fillimit të procesit të bartjes të numrit Operatori Marrës është i detyruar të verifikojë identitetin e **personit/pajtimtarit aplikues që depoziton kërkesën për portim numri.**
Nëse aplikuesi është pajtimtar i kategorisë konsumator (individ) tek ODH identifikimi i pajtimtarit/aplikuesit nga OM kryhet me anë të verifikimit të një mjeti/dokumenti identifikimi që vërteton identitetin e personit përfshirë Numrin Personal të Identifikimit të tij nëpërmjet një dokumenti të vlefshëm identifikues si Kartë Identiteti ose Pasaportë.

Nëse aplikuesi është pajtimtar i kategorisë Biznes (subjekt fizik ose juridik) te ODH, identifikimi aplikuesit nga OM kryhet nëpërmjet verifikimit të një mjeti/dokumenti identifikimi që vërteton identitetin e personit të autorizuar që

përfaqëson aplikuesin përfshirë Numrin Personal të Identifikimit të tij nëpërmjet një dokumenti të vlefshëm identifikues si Kartë Identiteti ose Pasaportë, si dhe nëpërmjet verifikimit të një ekstrakti të thjeshtë/historik të subjektit fizik ose juridik.

Në përfundim të procesit të portimit të suksesshëm të numrit, Operatori Marrës regjistron të dhënat e pajtimtarit të portuar sipas formularit përkatës të regjistrimit të miratuar nga AKEP sipas përcaktimeve ligjore.

Operatori Marrës ka detyrim të mbajë dhe ruaj në arkivë të gjithë dokumentacionin e procesit të portimit të numrit, përfshirë kërkesën për portim të numrit, dhe me kërkesë të AKEP ta depozitojë në rrugë elektronike ose shkresore brenda afatit të kërkuar nga AKEP,

2. Operatori Marrës nëpërmjet sistemit CRDB duhet t'i dërgojë Operatorit Dhënës kërkesën për bartjen e numrit, bazuar në kërkesën e pajtimtarit sipas formularit në Aneks 1. Operatori marrës ka detyrim të pajisë pajtimtarin me një kopje të printuar ose elektronike të kërkesës për portim sipas formularit në Aneks 1. Nëse koha e hedhjes në sistemin CRDB e kërkesës nga operatori marrës celular është e ndryshme nga koha depozitimit të kërkesës nga pajtimtari, operatori marrës njofton pajtimtarin nëpërmjet SMS për kohën e hedhjes në sistem të kërkesës së tij për portim. Në cdo rast OM hedh kërkesën në sistemin CRDB jo më vonë se një ditë pune nga depozitimi i kërkesës nga pajtimtari.
3. Operatori Marrës është i detyruar të sigurojë që përdorimi i numrit pas importimit është në përputhje me rregullat për përdorimin e numrave sipas Rregullores përkatëse të AKEP për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit.
4. Operatori Marrës duhet të informojë pajtimtarin i cili bën kërkesë të bartë numrin, në lidhje me procesin e transferimit të numrit për:
 - a. periudhën se kur do të kryhet procesi i bartjes,
 - b. periudhën se kur do t'i fillojë aktivizimi i shërbimit në rrjetin e OM
 - c. shërbimet e Operatorit Marrës,
 - d. përgjegjësitë dhe kushtet e transmetimit të njoftimeve paralajmëruese për pajtimtarët kur thirrësi telefonon në numrat e bartur
 - e. arsyet për refuzimin të kërkesës për bartjen e numrave
 - f. arsyet e vonësive në transferimin e numrave.
5. Nëse Operatori Marrës drejton procesin e bartjes pa autorizimin e pajtimtarit, numri do të kthehet në rrjetin e Operatorit Dhënës dhe pajtimtari dhe Operatori Dhënës kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për dëmin.
6. Për përfitimin e shërbimeve në rrjetin e tij, përveç informacionit të kërkuar nga neni **141 i ligjit 54/2024**, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nën-ligjore, operatori marrës është i detyruar t'i ofrojë pajtimtarit që bën kërkesën për portim të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti informacionin në Aneks 1 të kësaj Rregulloreje.
 - a) **që kërkesa për bartje të një Numri Aktiv përbën kërkesë për mbyllje të kontratës ekzistuese me ODH, dhe realizimi i bartjes së numrit do të përfundojë automatikisht** kontratën ekzistuese të pajtimtarit me operatorin Dhënës, por nuk do t'i përfundojë detyrimet e tij me ODH sipas kontratës ekzistuese (**apo të kontratës së mëparshme nëse kërkesa për portim është për një Numër të Çaktivizuar**), në

rast se ka detyrime të tilla dhe që duhen paguar/përmblusur sipas njoftimit/njoftimeve përkatëse të ODH.

- b) çdo detyrim që pajtimtari duhet t'i paguajë Operatorit Marrës para lidhjes së kontratës; dhe
- c) nëse është e nevojshme, specifikimet teknike të ndërfaqes së rrjetit të operatorit Marrës dhe nëse pajtimtari do të mund të përdorë pajisjet fundore ekzistuese në rrjetin e operatorit marrës.

Neni 15

Detyrimet e Operatorit Dhënës

1. Të gjithë operatorët dhënës të cilët përdorin numra fiks ose të lëvizshëm kanë detyrim të mbështesin procesin e bartjes dhe realizimin e bartjes së numrave drejt OM në përputhje me përcaktimet e kësaj Rregulloreje.
2. Operatori Dhënës nuk është i detyruar të pranojë kërkesën për portimin e një numri drejt OM nëse ky numër është:
 - a) Numër Aktiv sipas përcaktimit në pikën 12, Neni 4 të kësaj Rregulloreje, që ka më pak se 3 muaj që është aktivizuar për herë të parë tek ODH (si numër i ri apo si numër i bartur nga një ODH tjetër);
 - b) Numër i Çaktivizuar, sipas përcaktimit në pikën 13, Neni 4 të kësaj Rregulloreje, për më shumë se 3 muaj nga ODH,
 - c) Numër i Çaktivizuar, sipas përcaktimit në pikën 13, Neni 4 të kësaj Rregulloreje, për të cilin përdoruesi fundor në përfundim të kontratës me ODH ka hequr dorë në mënyrë të shprehur nga e drejta për portimin e tij pas çaktivizimit të numrit.
3. Operatori Dhënës është i detyruar të kryejë bartjen e numrit edhe kur shërbimet e kontraktuara me pajtimtarin janë pezulluar ose ndërprerë përkohësisht në mënyrë të njëanshme përpara konsiderimit të përfunduar të kontratës sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore përkatëse, për shkak të mospagesës nga pajtimtari të detyrimeve të faturuara; Në rastet kur për shkak të mos pagesës së faturës mujore pajtimtari gjendet në kushtet e ndërprerjes së njëanshme të shërbimeve të kontraktuara, operatori dhënës është i detyruar të pranojë me kusht kërkesën për bartje dhe kërkesa do të pranohet dhe numri do të bartet vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimin e faturuar nga ODH sipas përcaktimeve në këtë Rregullore.
4. Operatori dhënës/transferues, përveç sa parashikohet në Nenin 141 dhe Nenin 180 të ligjit 54/2024 dhe aktet nënligjore përkatëse, siguron që përdoruesit fundorë/pajtimtarët informohen në mënyrën e përshtatshme në kontratë/termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për të drejtat e portimit të numrit dhe të drejtën e rimbursimit për kreditet e mbetura ose të papërdorura në përdorimin e shërbimeve me parapagim si dhe për të drejtën për kompensimin në rastet e vonesave apo abuzimeve nga ODH për portimin e numrit të pajtimtarit, sipas përcaktimeve të pikave 1/c/ii dhe 1/c/iii të Nenit 180 të ligjit 54/2024.
5. Në rast se një numër i portuar kalon në statusin Numër i Çaktivizuar (sipas përcaktimit në Nenin 4, pika 13 e kësaj Rregulloreje) dhe qëndron në këtë status për më shumë se 3 muaj nga data e çaktivizimit dhe përdoruesi fundor i mëparshëm i tij nuk e ka ushtruar të drejtën portimit brenda këtij afati, ose numri i hiqet pajtimtarit për shkaqe të përcaktuara në aktet ligjore dhe nën-ligjore, ky numër i

bartur i kalon Operatorit Dhënës Fillestar (ODHF), i cili zotëron të drejtën e përdorimit të numrit nga AKEP. Operatori Marrës njofton ODH për këto numra duke përditësuar dhe informacionin në CRDB sipas udhëzimeve të operatorit të CRDB.

6. Të gjithë operatorët celularë kanë detyrimin që cdo tre muaj, gjatë 5 ditëve të para të punës së muajve Janar, Prill, Korrik dhe Tetor të kryejnë procesin re-patriate (Rikthim drejt operatorëve dhënës fillestar) të numrave të portuar në rrjetet e tyre që **kanë qëndruar në statusin Numër i Çaktivizuar për më shumë se 3 muaj nga data e çaktivizimit**. Për rrjete fikse përditësimi dhe procesi i rikthimit kryhet cdo vit në muajin Janar.
7. Të dhënat e pajtimtarit që ka bërë kërkesë për portim trajtohen nga ODH me konfidencialitet maksimal dhe përdoren ekskluzivisht për qëllim të realizimit të portimit të numrit. Operatori Dhënës, **gjatë periudhës 30 ditore të statusit pezull të krijuar sipas përcaktimeve të Nenit 18 të kësaj Rregulloreje për një kërkesë për portim të pranuar me kushtin e shlyerjes së detyrimeve kontraktore nga pajtimtari me paspagim**, ndalohet të japë oferta/bonuse apo kushte të tjera favorizuese individuale për pajtimtarin që ka bërë kërkesë për portim.
8. **ODH ka të drejtë të refuzojë një kërkesë për portim numri vetëm për arsyet e referuara në Nenin 18, pika 5/c të kësaj Rregulloreje.**
9. **ODH ka të drejtë të pranojë me kusht një kërkesë për portim numri të pajtimtarit me paspagim vetëm nëse pajtimtari, në datën e marrjes së kërkesës për bartje nga ODH nëpërmjet CRDB/datën e pranimit me kusht të kërkesës, rezulton me “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” sipas pikës 19 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje.**

ODH, në “Detyrimet kontraktore për t’u përmbushur nga pajtimtari përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”, nuk mund të përfshijë detyrime të tjera shtesë, përveç atyre të specifikuara në kontratën ekzistuese midis ODH dhe pajtimtarit për shërbimin që përfshin numrin që do të bartet, dhe që janë të aplikueshme në rast të zgjidhjes/përfundimit të kontratës me kërkesë të pajtimtarit sipas përcaktimeve të nenit 144 të Ligjit 54/2024 dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme.

Detyrimet kontraktore për t’u përmbushur nga pajtimtari me/pas përfundimit të kontratës/portimit të numrit, sipas pikës 20 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje, nuk përbëjnë kriter për pranimin me kusht të një kërkesë për portim të një Numri Aktiv. Këto detyrime mund paguhen/përmbushen nga pajtimtari vetëm në datën e përfundimit të kontratës/ndërprerjes së shërbimit nga ODH ose pas kësaj date sipas njoftimit përkatës të ODH.

ODH ka të drejtë të pranojë me kusht një kërkesë për portim të një pajtimtari të mëparshëm me paspagim për një Numër të Çaktivizuar vetëm nëse pajtimtari/përdoruesi fundor, në datën e marrjes së kërkesës për bartje nga ODH nëpërmjet CRDB/datën e pranimit me kusht të kërkesës, rezulton me detyrime të papërmbushura sipas kontratës së mëparshme me ODH (mund të jetë cdo lloj i detyrimi i papërmbushur sipas pikave pika 19 dhe 20 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje).

10. ODH ka detyrim të pranojë kërkesën për portim të numrit të pajtimtarit nëse asnjë prej kritereve të refuzimit dhe pranimit me kusht nuk plotësohen.
11. ODH në rastet e refuzimit të kërkesave për portim numri për shkak të mos-përputhjes së ID/NIPT ose pranimit me kusht të kërkesës për portim të një numri me paspagim, njofton dhe informon pajtimtarin me mjet të qëndrueshëm komunikimi (SMS për operatorët celularë) si dhe kryen veprimet dhe proceset pëkatëse për saktësimin e ID dhe/ose realizimin e portimit të numrit sipas kërkesave dhe afateve specifikuar në pikat 12/b, 13 dhe 14 të Nenit 18 të kësaj Rregulloreje.
12. ODH pas datës së portimit/ndërprerjes së shërbimit ka të drejtë të faturojë pajtimtarin me paspagim vetëm për “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”, të cilat janë detyrime shitesë të lindura gjatë statusit pezull, të cilat nuk janë përfshirë në faturimin e “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”, ose që mund përmbushen nga pajtimtari vetëm pas ndërprerjes së shërbimit/kontratës nga ODH si kthimi i pajisjes fundore.
13. ODH siguron që të dhënat e pajtimtarëve në databazën/databazat e pajtimtarëve të përdorur për verifikim të kërkesave për portim të numrit të jenë të sinkronizuara me të dhënat e pajtimtarëve në databazën/databazat e pajtimtarëve të përdorur nga stafi i ODH në pikat e shitjes së sipërmarrësit.
14. Operatori Dhënës, sipas kërkesës, ka detyrim të rimbursojë pajtimtarët e kategorisë konsumator për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin me parapagim të shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme sipas përcaktimeve në Nenin 22 të kësaj Rregulloreje.

Neni 16

Të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit

1. Portabiliteti i numrit është e drejtë e pajtimtarit në marrëdhëniet e tij kontraktore me operatorin Dhënës dhe atë Marrës. Pajtimtari ka të drejtën të mbajë numrin kur ndryshon operatorin.
2. Një pajtimtar/përdorues fundor mund të bartë numrin duke nënshkruar kontratë me operatorin Marrës dhe duke nënshkruar tek OM kërkesën për portim të numrit nga ODH (sipas Aneks 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje).
Kërkesa e pajtimtarit për bartje të një Numri Aktiv e nënshkruar tek OM, përbën shprehje të dëshirës së pajtimtarit për të ndërprerë/mbyllur kontratën ekzistuese me Operatorin Dhënës dhe dërgimi i kërkesës nga OM tek ODH nëpërmjet CRDB **përbën kërkesë për mbyllje të kontratës ekzistuese të pajtimtarit me ODH.**
Kontrata ekzistuese me ODH dhe kontrata e re me OM mund të jenë me parapagesë ose pas pagesë. **Kontrata e re me OM hyn në fuqi vetëm në rast të realizimit me sukses të portimit të numrit dhe në datën e aktivizimit të numrit të portuar tek OM.**
3. **Realizimi/përfundimi me sukses i procesit të bartjes së një Numri Aktiv ndërpret automatikisht** kontratën mes pajtimtarit dhe operatorit Dhënës, por nuk i përfundon detyrimet e pajtimtarit sipas kontratës ekzistuese me ODH, të cilat ekzistojnë para realizimit të bartjes.
Realizimi/përfundimi me sukses i procesit të bartjes së një Numri të Çaktivizuar nuk i përfundon detyrimet e kontratës së mëparshme me ODH të cilat ekzistojnë

para realizimit të bartjes.

Në veçanti, pajtimtari me paspagim është i detyruar të paguajë (shlyejë) apo përmbushë çdo detyrim, **sipas pikës 19 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje (nëse është e aplikueshme), që rrjedh nga kontrata ekzistuese (ose e mëparshme për një Numër të Çaktivizuar) me Operatorin Dhënës perpara pranimit/ekzekutimit të kërkesës për bartje dhe/ose çdo detyrim, sipas pikës 20 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje (nëse është e aplikueshme), që rrjedh nga kontrata ekzistuese me Operatorin Dhënës dhe që mund të përmbushet vetëm pas ndërprerjes së shërbimit nga ODH/portimit të numrit të pajtimtarit.**

4. Asnjë kontratë mes pajtimtarit dhe operatorit nuk mund përjashtojë të drejtën e pajtimtarit për të bartur numrin. Klauzolat e kontratës të cilat përjashtojnë ose kufizojnë të drejtën e pajtimtarit për të bartur numrin, **në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 54/2024 dhe të kësaj Rregulloreje,** janë të pavlefshme.
5. Pajtimtari **me paspagim, kërkesa e të cilit për portim numri është pranuar me kusht nga ODH,** duhet ti paguajë operatorit dhënës të gjitha detyrimet/faturat e papaguara që dalin nga kontrata ekzistuese, **sipas pikës 19/a dhe 19/b të nenit 4 të kësaj Rregulloreje dhe njoftimit përkatës të ODH për këtë qëllim,** perpara pranimit/ekzekutimit të kërkesës për bartje nga ODH. **Në rast të kundërt kërkesa për portim anulohet automatikisht/konsiderohet e refuzuar në përfundim të afatit 30 ditor.**
6. Pajtimtari **me paspagim, kërkesa e të cilit për portim numri është pranuar me kusht nga ODH,** duhet të perfundojë të gjitha detyrimet e aplikueshme që rrjedhin nga kontrata ekzistuese për shkak të përfundimit para afatit të caktuar të saj, përfshirë kompensim për aparate telefonike apo **pajisje të tjera fundore të subvencionuara/përfshira në paketën tarifore të integruar, sipas pikës 19/c të nenit 4 të kësaj Rregulloreje dhe njoftimit përkatës të ODH për këtë qëllim,** perpara pranimit/ekzekutimit të kërkesës për bartje nga ODH.
7. Pajtimtarit i lind e drejta e bartjes së numrit vetëm 3 muaj pasi është bërë pajtimtar i operatorit dhënës (**nëpërmjet pajisjes/aktivizimit të shërbimeve me një numër të ri nga operatori dhënës apo** nëpërmjet bartjes së numrit nga një operator dhënës tjetër), **dhe e ruan të drejtën për portimin e këtij numri si përdorues fundor i mëparshëm i tij deri në 3 muaj pas datës së përfundimit të kontratës/çaktivizimit të numrit nga ODH.**

Pajtimtari/përdoruesi fundor ka të drejtë të kërkojë portimin e një Numri Aktiv që aktualisht është në përdorim të tij tek ODH ose të një Numri të Çaktivizuar që ka genë në përdorim të tij tek ODH, sipas afateve të mëposhtme:

- **Numër Aktiv: jo më herët se 3 muaj nga data që është bërë pajtimtar i ODH (data e aktivizimit për herë të parë të numrit tek ODH si numër i ri apo i portuar nga /ODHF)**
- **Numër i Çaktivizuar: jo më vonë se 3 muaj nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme/çaktivizimit të numrit nga ODH, përveç rasteve kur përdoruesi fundor ka hequr dorë në mënyrë të shprehur nga kjo e drejtë.**

(Shënim: Numri Aktiv/Çaktivizuar që kërkohet të portohet mund të jetë një numër që është aktivizuar për herë të parë si numër i ri tek ODH (ODHF) ose numër i portuar më parë tek ODH nga një operator tjetër dhënës).

8. Pajtimtarët janë të detyruar që të njoftojnë sipërmarrësin me të cilin kanë lidhur kontratë e pajtimit, për çdo ndryshim të të dhënave të tyre të rregjistruara në bazën e të dhënave të sipërmarrësit të bazuar në dokumentacionin përkatës. Gjatë procesit të ekzekutimit të kërkesës për portim, pajtimtari mund të ketë nevojë për saktësim të identifikimit në rrjetin e operatorit Dhënës sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje.
9. **Pajtimtarët e kategorisë konsumatorë kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim nga ODH për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim deri në datën e ndërprerjes së shërbimit/portimit të numrit nga ODH, sipas përcaktimeve në Nenin 22 të kësaj Rregulloreje.**

Neni 17

Procedura administrative e bartjes

1. Procesi për bartje nisët nga pajtimtari. Pajtimtari kontakton Operatorin Marrës dhe shpreh me shkrim vullnetin për të lidhur kontratë/përfitur shërbime prej tij dhe për të bartur numrin e caktuar sipas Aneksit 1 të kësaj Rregulloreje. Operatori Marrës informon pajtimtarin për të drejtat dhe detyrimet sipas përcaktimeve në këtë Rregullore.
2. Pasi Operatori Marrës ka përfunduar identifikimin dhe informimin e pajtimtarit sipas përcaktimeve në këtë Rregullore dhe është i gatshëm të nënshkruajë një kontratë (me paspagim ose parapagim) me pajtimtarin dhe të importojë numrin, dhe pajtimtari bie dakort për termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimit nga Operatori Marrës, pajtimtari plotëson dhe nënshkruan Formulari përkatës për portimin e numrit sipas Aneks 1 të kësaj Rregulloreje. Afatet për procesin e bartjes llogariten duke filluar nga Koha e Hedhjes në Sistemin CRDB nga OM të Kërkesës për bartje.
3. Pajtimtari nuk mund të heqë dorë nga kërkesa për bartje të numrit pasi ka plotësuar formularin dhe kërkesën për bartje tek operatori marrës dhe kërkesa për bartje është hedhur në CRDB nga OM.
4. Operatori Marrës do të kontrollojë aplikimin e pajtimtarit sipas procedurave të zakonshme dhe do të vazhdojë me procesin e bartjes sipas përcaktimeve në këtë Rregullore. Në rast se operatori Marrës refuzon ofrimin e shërbimeve për pajtimtarin ai e informon atë me shkrim (SMS, email, letër etj), përfshirë arsyet e refuzimit.

Neni 18

Kërkesa dhe përgjigja për bartje

1. Pas plotësimit nga pajtimtari të kërkesës për bartjen e numrit sipas Nenit 17 të kësaj Rregulloreje, Operatori Marrës dërgon në CRDB kërkesën për bartje, menjëherë apo brenda afateve të përcaktuara në këtë Rregullore, por jo më vonë se një ditë pune nga koha e depozitimit të kërkesës nga pajtimtari, duke njoftuar pajtimtarin për kohën e hedhjes në sistem të kërkesës, sipas përcaktimeve në këtë Rregullore. Kërkesa për bartje përmban dhe është sipas formularit në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje.
2. Operatori Dhënës njoftohet nëpërmjet CRDB për kërkesën për bartjen e numrit, përfshirë dhe datën e dëshiruar të transferimit të numrit sipas Formularit në Aneks 1.
3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë kontrollon saktësinë e kërkesës për bartje sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti nëse numri i cili do të bartet është numër gjeografik ose i lëvizshëm dhe nëse numri është saktësisht i vendosur në rrjetin e operatorit Dhënës. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e

centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit Marrës. Operatori Marrës është i detyruar që në bashkëpunim me operatorin Dhënës dhe pajtimtarin të kryejnë brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore korrigjimin e gabimit të konstatuar në kërkesën për bartje.

- a. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit Marrës.
 - b. Nëse baza e të dhënave referencë e centralizuar nuk zbulon ndonjë gabim, menjëherë regjistron kërkesën për bartje, cakton një numër referencë dhe konfirmon pranimin e kërkesës, duke përfshirë numrin e caktuar të referencës. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë ridrejton kërkesën për bartje operatorit Dhënës, duke përfshirë numrin e caktuar referencë.
4. Kur Operatori Dhënës merr një kërkesë për bartje, do të kontrollojë, **sipas rendit të mëposhtëm:**
- i. **nëse numri që do të bartet është Numër Aktiv ose Numër i Çaktivizuar tek ODH (sipas përcaktimeve të pikave 12 dhe 13 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje) dhe afatet përkatëse për të drejtën për kërkuar portimin e numrit Aktiv/Çaktivizuar (sipas përcaktimeve të pikës 7 të Nenit 16 të kësaj Rregulloreje);**
 - ii. nëse numri personal i identifikimit (ID) i regjistrimit të pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje përputhet me numrin e ID të pajtimtarit në bazën e të dhënave të pajtimtarëve të operatorit Dhënës;
 - iii. nëse numri NIPT i pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje përputhet me numrin NIPT të regjistrimit të pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit Dhënës (Aplikohet vetëm për pajtimtarët që janë persona fizikë dhe juridikë të regjistruar me numër NIPT).
 - iv. nëse numri që do të bartet ka detyrime kontraktore të papërmblushura sipas kontratës ekzistuese **për një Numër Aktiv apo kontratës së mëparshme për një Numër të Çaktivizuar** (aplikohet vetëm për numrat me paspagim).

Kontrolli/verifikimi nga ODH duhet të jetë plotësisht automatik në databazën e pajtimtarëve të tij (me parapagim dhe paspagim) për fushat e mëposhtme:

- Numri MSSIDN;
- Statusi (Aktiv/Çaktivizuar) **dhe data e Aktivizimit/Çaktivizimit:**
- ID e pajtimtarit (Numri Personal i Identifikimit sipas ID për individë ose NIPT për biznese dhe ID për përdoruesit individualë të numrave)
- Debitor/Detyrime kontraktore

Verifikimi/kontrolli për detyrime të papërmblushura (që aplikohet vetëm për përdoruesit/pajtimtarët me paspagim) mund të kryhet nëpërmjet komunikimeve të brendshme në strukturat e ODH, por nuk duhet të zgjasë më shumë se 4 orë pune nga marrja e kërkesës.

5. Pas ekzaminimit, Operatori Dhënës do të dërgojë përgjigjen për kërkesën për bartje në bazën e të dhënave referencë të centralizuar. Përgjigja për bartje përmban:
- a) numrin referencë të këtij procesi të bartjes;
 - b) **Pranim (Miratim), Refuzim (përgjigje negative), ose Pranim me Kusht të**

kërkesës;

c) në rast të përgjigjes negative (Refuzim), një tregues lidhur me arsyen përkatëse të refuzimit të kërkesës për bartje. Përveç rasteve të tejkalimit të kapacitetit ditor sipas pikes 10 më poshtë, kërkesa mund të refuzohet vetëm për arsye të mëposhtme

i. numri që do të bartet nuk është i vendosur tek Operatori Dhënës;

Kjo përgjigje gjenerohet automatikisht nga CRDB

ii. numri i cili do të bartet nuk ka të drejtë portimi, pasi numri është:

a. Numër Aktiv por përdoruesi fundor i tij ka më pak se 3 muaj si pajtimtar i ODH, ose

b. Numër i Çaktivizuar për më shumë se 3 muaj nga ODH, ose

c. Numër i Çaktivizuar për të cilin përdoruesi fundor ka hequr dorë në mënyrë të shprehur nga e drejta për portimin e tij

iii. Numri Personal i Identifikimit (ID) të pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje nuk përputhet me ID-në e pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit Dhënës;

iv. numri NIPT i pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje nuk përputhet me numrin NIPT të regjistrimit të pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit Dhënës (Aplikohet vetëm për pajtimtarët që janë subjekte juridikë të regjistruar me numër NIPT **tek ODH**).

d) në rast të përgjigjes për Pranim me Kusht të **kërkesës për portim, arsyen që pajtimtari/përdoruesi fundor që ka bërë kërkesën për portim ka detyrime të papërmbushura sipas kontratës ekzistuese (kur kërkesa është për portim Numër Aktiv) ose të mëparshme (kur kërkesa është për portim Numër i Çaktivizuar). Përgjigja nga ODH për Pranimin me Kusht të kërkesës për portim aplikohet vetëm për pajtimtarë me paspagim në rastet kur pajtimtari/përdoruesi fundor⁶ i numrit që ka bërë kërkesën për portim:**

- **për një Numër Aktiv ka detyrime të papërmbushura sipas kontratës ekzistuese vetëm për “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” sipas pikës 19 të Nenit 4 të kësaj Rregullorje**
- **për një Numër të Çaktivizuar ka detyrime të papërmbushura sipas kontratës së mëparshme me ODH (mund të jetë cdo lloj i detyrimi i papërmbushur sipas pikave pika 19 dhe 20 të Nenit 4 të kësaj Rregullorje).**

Përgjigja e ODH për Pranim me Kusht dërgohet në CRDB, ku krijohet Statusi Pezull dhe OM njoftohet se kërkesa është Pranuar me Kusht dhe kalon në Statusin Pezull.

Kërkesa për portim do të qëndrojë në Statusin Pezull deri sa pajtimtari të shlyejë detyrimet përkatëse tek ODH, por jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e krijimit të këtij statusi.

Me përmbushjen e detyrimeve të pajtimtarit, ODH pranon kërkesën për bartje, duke njoftuar OM nëpërmjet sistemit CRDB, dhe kërkesa kalon nga Statusi Pezull në Status të Pranuar dhe më pas vijojnë proceset përkatëse për realizimin e portimit të numrit.

⁶ Nëse kontrata me pajtimtarë Biznes, përfshin një grup numrash celularë dhe përdorues të ndryshëm të tyre, detyrimet (dhe kontratat) për përdoruesit që paguajnë individualisht faturat e lëshuara nga operatori për numrat në përdorim (pra nuk paguhen nga pajtimtari Biznes), janë individuale dhe në këto raste këtyre përdoruesve nuk mund t’u mohohet e drejta /refuzohet kërkesa për portim për shkak të detyrimeve apo përfitimeve të përdoruesve të tjerë të këtij grupi apo pajtimtari Biznes.

Në rast të mospërbushjes së detyrimeve nga pajtimtari/mosdërgimit të mesazhit të pranimit të kërkesës nga ODH brenda afatit maksimal 30 ditor të Statusit Pezull, rasti mbyllet nga CRDB dhe kërkesa konsiderohet e Refuzuar.

Në raste të përgjigjes negative (**refuzimit për arsyet në pikat c/iii dhe c/iv më sipër) dhe pranimit me kusht të kërkesës (pika ‘d’ më sipër)**, Operatori Dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarin dhe Operatorin Marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit të konstatuar në të dhënat e Pajtimtarit dhe/ose pagesën e detyrimeve nga pajtimtari me qëllim realizimin e procesit të bartjes së numrit brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore.

Gjatë këtij procesi Operatori Dhënës ndalohet të japë oferta/bonuse të individualizuara për pajtimtarin.

6. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar dhe procesuar kërkesat për bartje dhe përgjigjet për to në rolin e Operatorit Dhënës. Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nëpërmjet sistemit të CRDB nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta të 100% të rasteve të muajit kalendarik për pajtimtarët me parapagim. Për përdoruesit celularë me paspagim ky afat nuk do të jetë më i gjatë se 4 orë pune në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më i gjatë se 1 (një) ditë pune të 100% të rasteve të muajit kalendarik
7. Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes, në rastin e kërkesës për bartje të mbi 100 numrave të një pajtimtari të **kategorisë Biznes**, nuk do të jetë më e gjatë se 3 ditë pune.
8. Për operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike fikse, koha mes pranimit të kërkesës për bartje dhe përgjigjes nëpërmjet sistemit të CRDB nuk do të jetë më e gjatë se 6 orë pune në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më e gjatë se 3 ditë pune në 100% të rasteve të muajit kalendarik.
9. Për operatorët fikse Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes në rastin e kërkesës për bartje të mbi 100 numrave të një pajtimtari të **kategorisë Biznes**, nuk do të jetë më gjatë se 5 ditë pune.
10. Numri maksimal i kërkesave që mund të pranohen në CRDB, drejtuar të njëjtit operator dhenes brenda një dite pune është **3000**. Numri maksimal i kërkesave që mund të pranohen në CRDB dhe të procesohen brenda ditës, drejtuar të njëjtit operator dhenes brenda një dite pune është **2500**. Kapacitetet e numrave maksimalë të pranuar të përcaktuara në këtë pikë mund të rriten, ndryshohen nëpërmjet akteve të vecanta administrative të nxjerra nga AKEP në zbatim të kësaj Rregulloreje dhe në funksion edhe të përmirësimeve në sistemin CRDB (hardëare dhe softëare) dhe dinamikave të tregut.
11. Nëse operatori Dhënës nuk e dërgon përgjigjen për bartje brenda afateve të përcaktuara në paragrafët 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij neni baza e të dhënave referencë e centralizuar do të veprojë sikur të ketë pranuar përgjigje pozitive për bartje.
12. Në rast të refuzimit apo pranimit me kusht të kërkesës për bartje nga ODH, **për arsyet e cituara në pikat 5/c dhe 5/d më sipër:**
 1. OM pasi merr përgjigjen nga sistemi i CRDB, njofton **dhe informon** menjëherë pajtimtarin (me SMS për operatorët celularë) për arsyet e refuzimit **apo pranimit me**

kusht të kërkesës si dhe alternativat e korigjimit të gabimeve/shlyerjes së detyrimeve:

- i. Në rast të refuzimit për shkak të mos-përputhjes së ID, pajtimtari këshillohet të kontaktojë ODH për saktësim të të dhënave të ID të regjistruar tek ODH.
- ii. Në rast të pranimit me kusht, pajtimtari informohet se ka detyrime kontraktore ndaj ODH dhe këshillohet të shlyejë/përmbushë **ato sipas njoftimit që do marrë prej ODH.**

2. ODH, jo më vonë se 8 orë/1 (një) ditë pune nga refuzimi i kërkesës për bartje për shkak të mospëputhjes së ID/NIPT ose nga pranimi me kusht i kërkesës për bartje, njofton dhe informon pajtimtarin (me SMS për operatorët celularë) për **arsyen/arsyet e refuzimit apo pranimit me kusht të kërkesës për portim të numrit, duke përfshirë në këtë njoftim edhe:**

- i. **Në rast të refuzimit për shkak të mos-përputhjes së ID/NIPT:**
 - **Numrin Personal të Identifikimit (NIPT për pajtimtarët Biznes) të pajtimtarit i regjistruar tek ODH,**
 - **Këshillën që pajtimtari të paraqitet në një nga pikat e shitjes së ODH, për të saktësuar të dhënat e identifikimit sipas formularit përkatës.**
- ii. **Në rast të pranimit me kusht të kërkesës për shkak të detyrimeve të pajtimtarit me paspagim:**
 - **Informimin për vlerën monetare totale dhe të detajuar të “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” sipas specifikimeve në pikën 19, neni 4 të kësaj Rregulloreje që pajtimtari duhet të paguajë si kusht për pranimin e kërkesës për bartje nga ODH/ndërprerjen e kontratës me ODH, si dhe afatin maksimal për pagesën e këtyre detyrimeve, prej 28 ditë kalendarike nga data e njoftimit, si dhe që në rast mospagese të këtyre detyrimeve kërkesa për portim do të refuzohet dhe marrëdhëniet midis pajtimtarit dhe ODH do të vijojnë sipas kontratës ekzistuese.**
 - **Informimin për “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”, sipas specifikimeve në pikën 19, neni 4 të kësaj Rregulloreje, nëse ka, të tilla si faturimi për periudhën e mbetur deri në datën e ndërprerjes së kontratës/shërbimit nga ODH dhe/ose kthimi i pajisjes fundore të përfshirë në paketën tarifore të integruar ose kompensimi për pajisjen në rast të moskthimit të saj brenda afatit të caktuar nga ODH sipas kontratës ekzistuese (jo më herët se data e ndërprerjes së shërbimit nga ODH).**

13. Me paraqitjen e pajtimtarit tek ODH, **sipas përcaktimeve në pikën 12/b më sipër, ODH:**

- kryen identifikimin dhe saktësimin e të dhënave të pajtimtarit sipas ID **dhe Numrit Personal të Identifikimit të paraqitur nga pajtimtari, nëpërmjet një dokumenti/mjeti të vlefshëm identifikimi, sipas formularit përkatës për këtë qëllim. ODH pajis pajtimtarin me një kopje të formularit të nënshkruar nga ODH.**
- **pajis pajtimtarin me faturën përkatëse për shlyerjen e “Detyrimeve kontraktore**

për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” dhe/ose me mandat-pagesën (vërtetimi shlyerjes/pagesës së detyrimeve përkatëse).

14. ODH, menjëherë, apo maksimumi:
 - brenda 1 (një) ore pune pas korigjimit/saktësimit të të dhënave të identifikimit,
 - **brenda 4 orë pune pas pagesës nga pajtimtari në një nga pikat e shitjes së ODH (8 orë/1 ditë pune pas pagesës së kryer në rrugë bankare/dorëzimit të mandat pagesës bankare nga pajtimtari) të të gjitha “Detyrimeve kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” (pika 19, neni 4 i kësaj Rregulloreje).**

përditëson databazën e tij të përshkruar në pikën 4 të këtij neni, si dhe kryen veprimet e mëtejshme për pranimin dhe/ose ekzekutimin e kërkesës për portim.
15. OM dërgojnë kërkesa për portim në sistemin CRDB dhe ODH kthejnë përgjigje për kërkesat për portim në sistemin CRDB cdo ditë pune nga ora 8.00-17.00. Mesazhi për ekzekutimin e portabilitetit (Npexec) mund të dërgohet deri në 60 minuta përpara përfundimit të orarit të funksionimit të sistemit të CRDB më sipër.
16. Koha e aktivizimit të numrit të portuar nuk duhet të jetë më e gjatë se 24 orë nga koha e dërgimit në sistem të kërkesës nga OM. Përgjigje nga ky afat përbejnë rastet kur kërkesa duhet të procesohet gjatë ditëve të pushimit zyrtar ose kur kërkesa refuzohet **ose pranohet me kusht** nga ODH për shkak të arsyeve të përcaktuara në këtë rregullore. Në këto raste koha llogaritet nga momenti i hedhjes në sistemin CRDB të kërkesës nga operatori marrës. Përgjigje nga afati 24 orë përbën dhe rasti kur pajtimtari ka shprehur vullnetin në formularin sipas Aneks1 për realizimin e portimit në një afat më të gjatë se 24 orë.

Neni 19

Konfirmimi për bartje

1. Kur baza e të dhënave referencë e centralizuar merr përgjigje pozitive për bartje nga operatori Dhënës, do të kalojë menjëherë atë tek operatori marrës dhe do të regjistrojë këtë informacion në bazën e të dhënave.
2. Operatori marrës nuk mund të zgjedhë kohën e bartjes me vone se në ditën pasardhëse të punës, përveç rasteve kur pajtimtari kërkon që bartja të realizohet në afat tjetër. Afati kohor mes konfirmimit të bartjes dhe kohës së bartjes do të jetë jo më shumë se gjashtë orë.
3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar i përcjell menjëherë konfirmimin për bartje operatorit Marrës. Konfirmimi për bartje është konfirmim autentik për përfundimin e procesit të bartjes përmban:
 - a. numrin referencë të këtij procesi të bartjes;
 - b. numrin që do të bartet;
 - c. emrin e pajtimtarit,
 - d. kodin e operatorit Dhënës;
 - e. kodin e operatorit Marrës; dhe
 - f. datën dhe orën kur do të bëhet bartja.
4. Kur baza e të dhënave referencë e centralizuar merr përgjigje negative, do të ridrejtojë menjëherë përgjigjen tek operatori Marrës. Në këtë rast procesi i bartjes ka përfunduar pa sukses dhe në varësi të arsyes të dështimit operatorit Marrës mund të fillojë një proces

- tjetër.
5. Pajtimtarit gjatë procesit të transferimit të numrit, mund t'i ndërpriten shërbimet e komunikimeve elektronike, të cilat duhet të rifillojnë sa më shpejt të jetë e mundur, **por jo më vonë se 1 (një) ditë pune.**
 6. **Në rastin e dështimit të procesit të portimit që mund të rezultojë në humbje të shërbimit për pajtimtarin, për çfarëdolloj arsyeje pas pranimit të kërkesës për portim dhe mesazheve përkatës në CRDB për lëshimin e numrit nga ODH, OM duhet të informojë menjëherë pajtimtarin dhe ODH duke i kërkuar ODH që të riaktivizojë numrin dhe shërbimet e lidhura për përdoruesin fundor deri në portimin e suksesshëm të numrit. ODH duhet të riaktivizojë menjëherë, por jo më vonë se 1 ditë pune nga marrja e kërkesës së OM, dhe vijojë ofrimin e shërbimeve të tij për pajtimtarin me të njëjtat kushte dhe terma derisa shërbimet në ofruesin marrës të jenë aktivizuar.**
 7. **Operatorët e rrjetit të aksesit apo faciliteteve të tyre që përdoren nga ODH apo OM ose nga të dy bashkë për ofrimin e shërbimit të komunikimit zanor për pajtimtarët tyre, marrin masa për kryerjen pa vonesa të portimit dhe sigurimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje për përdoruesin fundor, sipas udhëzimeve të OM dhe/ose të ODH.**
Në çdo rast, të gjitha palët e përfshira në një proces portimi (OM, ODH dhe Operoret e rrjeteve të aksesit) duhet të sigurojnë që ndërprerja e shërbimit gjatë procesit të portimit të numrit të mos jetë më e gjatë se një ditë pune.

Neni 20

Përshkallëzimi/ Rishikimi

1. Çdo operator i cili përdor numra fiks ose të lëvizshëm do të emërojë një person kontakti, i cili do të ketë një numër telefoni si dhe një adresë email-i, i cili do të jetë përgjegjës për rastet të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet mesazheve standarde elektronike të përcaktuara në këtë kapitull. Baza e të dhënave referencë e centralizuar do të ketë një faqe Intraneti me detajet e kontaktit të gjithë personave të kontaktit të operatorit.
2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit Marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit Dhënës. Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit, operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, por jo më shumë se 8 orë pune për rastet e tjera, duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimit të procesit të bartjes
3. Nëse problemet e caktuara teknike ose operacionale përsëriten, **operatorët e komunikimeve elektronike dhe operatori i CRDB** do të bashkëpunojnë në zgjerimin e specifikimeve teknike në mënyrë që të zgjidhet ky problem.

KAPITULLI IV

Pagesat e operatorëve dhe rimbursime dhe kompensime për portabilitetin

Neni 21

Mbulimi i kostove financiare dhe pagesat

1. AKEP do të mbulojë kostot e sigurimit të disponueshmërisë së CRDB, të referuar në pikën 3 të Nenit 10 të kësaj Rregulloreje, sipas shpenzimeve përkatëse të parashikuara në buxhetin vjetor të tij.
2. Kostot/shpenzimet vjetore të AKEP të referuara në pikën 1 të këtij neni do të mbulohen/financohen tërësisht nga pagesat vjetore të operatorëve të komunikimeve elektronike për portabilitetin e numrit.
3. Pagesat e operatorëve të komunikimeve elektronike të referuara në pikën 2 të këtij neni do të llogariten nga AKEP bazuar në:
 - a. totalin e vlerave përkatëse të shpenzimeve të parashikuara në buxhetin vjetor të AKEP, apo të kontraktuara me operatorët përkatës ekonomikë të përzgjedhur sipas procedurave të parashikuara në Pikën 3 të Nenit 10 të kësaj Rregulloreje (Operatorin e CRDB, dhe/ose sipas rastit dhe operatorin ekonomik të ambienteve të hostimit dhe/ose operatorin ekonomik që ofron platformën (hardëare) dhe sistemet e operimit (softëare) të CRDB (për herë të parë dhe/ose përmirësime të mëvonshme të nevojshme të saj/tyre)).
 - b. Koeficientin e llogaritur nga AKEP si raport i Shpenzimeve totale të referuar në pikën “a” me Sasinë totale të numrave të portuar gjatë vitit financiar/kalendarik të mëparshëm (kosto për një numër të portuar);

Detyrimi vjetor për t’u paguar nga secili operator i komunikimeve elektronike i do të llogaritet nga AKEP në mënyrë proporcionale, duke shumëzuar Sasinë respektive të numrave të portuar/të përfituar nga secili operator si OM (port-in) gjatë vitit financiar/kalendarik të mëparshëm me Koeficientin/koston për një numër të portuar të llogaritur sipas pikës ‘b’ të paragrafit të mësipërm.

4. Pagesa e llogaritur për secilin operator sipas pikës 3 të këtij neni iu faturohet atyre nga AKEP në muajin Janar të çdo viti korrent dhe ata janë të detyruar të kryejnë pagesën në numrin e llogarisë së përcaktuar në faturë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së faturës.
5. Çdo operator do të mbulojë vetë kostot e tij financiare për adaptimin e rrjetit për të mundësuar bartjen e numrit dhe kostot për mirëmbajtjen e faciliteteve, përfshirë automatizimin e procesve të procesimit të kërkesave për dhënie përgjigje si ODH.
6. ODH dhe OM kanë detyrim që të mos aplikojnë për përdoruesit fundorë/pajtimtarët e tyre asnjë pagesë/tarifë direkte për shërbimin e portimit të numrit, përfshirë tarifa nga ODH për ndryshim plani tarifar me paspagesë në paragim për pajtimatrë që kanë shprehur dëshirën për portim numri.
7. ODH ka të drejtë të aplikojë tarifë (me shumicë) ndaj OM për portimin e numrit, e cila paguhet nga OM sipas faturës përkatëse mujor, dhe kjo tarifë nuk duhet të jetë më e lartë se:
 - a. 500 Lek (pa TVSH)/ 600 Lek (me TVSH) për cdo numër të portuar me sukses nga ODH drejt OM

- b. 250 Lek (pa TVSH)/ 300 Lek (me TVSH) për cdo kërkesë për portim numri të refuzuar për shkak të gabimeve (informacion i gabuar për ID, numër telefoni) në kërkesën për portim të OM të hedhur në CRDB (për kërkesat me shumë numra llogaritet në bazë të numrave të refuzuar)

Neni 22

Rimbursimi i krediteve të papërdorura të shërbimit me parapagim

1. Pajtimtarët e kategorisë konsumator që janë përdorues me parapagim të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike (të lëvizshme) kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim nga ODH për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në datën e ndërprerjes së shërbimit nga ODH/datën e portimit të numrit.
2. ODH kryen rimbursimin e konsumatorit sipas përcaktimeve në kontratën ekzistuese me pajtimtarin dhe procedurave përkatëse për rimbursim, të hartuara dhe publikuara në përputhje me përcaktimet e pikës 1/c/iii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024, procedura të cilat duhet të jenë të thjeshta dhe në përputhje me përcaktimet e këtij neni dhe legjislacionit në fuqi.
3. ODH ka detyrim të kryejë rimbursimin e konsumatorit për kreditet e mbetura në bazë të kërkesës së konsumatorit me parapagim të depozituar tek ODH brenda një afati të arsyeshëm të caktuar nga ODH në procedurat e rimbursimit, afat i cili nuk duhet të jetë më pak se 14 ditë kalendarike nga data e portimit të numrit. ODH duhet të ofrojë mundësinë e paraqitjes së kërkesës për rimbursim nga konsumatorët në pikat e shitjes së ODH, si edhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike online (p.sh email ose kërkesa të depozitura online) që ODH mund të përdorë në marrëdhëniet me pajtimtarët dhe që mundësojnë identifikimin e pajtimtarit nga ODH.
4. ODH ka të drejtë të aplikojë një tarifë administrative për procesimin e kërkesës për rimbursimin vetëm kur ajo parashikohet në kontratën ekzistuese të ODH me konsumatorin. Tarifa e aplikuar në këto raste duhet të jetë proporcionale dhe në raportin e duhur ndaj kostove aktuale të ODH për ofrimin e rimbursimit. Tarifa administrative për rimbursim duhet të jetë fikse dhe e pavaruar nga vlera e rimbursuar, por në cdo rast jo më e lartë se 500 lekë (me TVSH).
5. Kredite të rimbursueshme të pajtimtarit me parapagim sipas pikës 1 më sipër, do të jetë vlera monetare e krediteve të parapaguara nga pajtimtari konsumator, të cilat janë të vlefshme për t'u përdorur apo vlera e mbetur e tyre në llogarinë e përdoruesit me parapagim (gjendja/balanca e mbetur e llogarisë me parapagim) në momentin e ndërprerjes së shërbimit nga ODH për shkak të portimit të numrit drejt OM. Në këtë vlerë nuk përfshihen kreditet e përdoruara tashmë për blerje të ofertave/paketave me parapagim dhe as vlera e krediteve të ofruar nga ODH si bonus apo promocion për pajtimtarin.
6. ODH kryen rimbursimin e konsumatorit duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi, në një nga mënyrat e mëposhtëme të pagesës:
 - Pagesë në Cash në një pikë shitje të ODH, ose
 - Pagesë me transfertë bankare nëse kjo kërkohet nga konsumatori sipas detajeve bankare të dhëna nga konsumatori në kërkesën për rimbursim.

7. ODH kryen rimbursimin e konsumatorit brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për rimbursim.
8. ODH, brenda 3 ditëve pune nga marrja e kërkesës për rimbursim, njofton konsumatorin me mjet të qëndrueshëm (SMS për kërkesat e paraqitura në pikën e shitjes të ODH dhe email për kërkesat e paraqitura me email ose online) duke e informuar në lidhje me:
 - Vlerën dhe mënyrën e rimbursimit, në rast se kërkesa për rimbursim është e vlefshme; ose
 - Arsyen e mospranimit të kërkesës për rimbursim (p.sh kërkesa është depozituar jashtë afatit sipas pikës 3 më sipër, dhe/ose konsumatori aplikues për rimbursim nuk ka kredite të mbetura të vlefshme në datën e ndërprerjes së shërbimit/portimit të numrit).

Neni 22/1

Kompensimi në rast të vonesave ose abuzimeve me procesin portimi

1. ODH/OM ka detyrim të kompensojë dhe/ose rimbursojë pajtimtarin për vonesat dhe/ose abuzimet e kryera nga ODH/OM në procesin e portimit të numrit sipas përcaktimeve në kontratën aktuale të ODH/kontratëve e re të OM me pajtimtarin dhe procedurave përkatëse për kompensimin dhe rimbursimin në rast vonese ose abuzimi gjatë procesit të ndërrimit të ofruesit të shërbimit/portimit të numrit, të hartuara dhe publikuara nga OM në përputhje me përcaktimet e pikës 1/c/ii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024 dhe aktet nënligjore të AKEP të nxjerra në zbatim të Ligjit 54/2024.
2. Vonesat dhe/ose abuzimet të kryera nga ODH/OM në procesin e portimit të numrit do të konsiderohen:
 - Kryerja e procesi portimi të numrit nga OM pa kërkesë nga pajtimtari;
 - Refuzim/pranim me kusht i kërkesës për portim numri nga ODH në kundërshtim me përcaktimet e kësaj Rregulloreje;
 - Tejkalim i afateve nga ODH në përgjigje për kërkesë për portim;
 - Tejkalimi i afateve nga OM për hedhjen në CRDB të kërkesës për portim.

Neni 23

Trajtimi i mosmarrëveshjeve për portimet

1. Operatori marrës dhe operatori dhënës në një proces portimi numri bashkëpunojnë me njëri-tjetrin mbi bazën e besimit të mirë, pa vonuar dhe abuzuar me proceset e portimit të numrave dhe nuk portojnë numrat pa miratimin e shprehur në mënyrë të qartë nga përdoruesi fundor.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi ndërmjet operatorëve ose ndërmjet pajtimtarëve dhe operatorëve për çështje që lidhen me zbatimin e portabilitetit të numrit dhe rregullimeve të përcaktuara në këtë rregullore, tentohet të zgjidhet ndërmjet palëve në mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila palë ka të drejtë t'i drejtohet AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore përkatëse zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve të rrjeteve të komunikimit elektronik dhe

ofruesve të shërbimeve të komunikimit elektronik, si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesve fundorë dhe operatorëve, **sipas dispozitave të ligjit 54/2024 dhe akteve nënligjore përkatëse.**

2. AKEP do të monitorojë cdo tre muaj nëpërmjet sistemit CRDB performancën e operatorëve për portimet si dhe do të kryejë inspektime/auditime në bazë të statistikave të ankesave të pajtimtarëve dhe CRDB, si dhe në raste individuale të problemeve me zbatimin e portabilitetit sipas përcaktimeve të **ligjit 54/2024** dhe kësaj Rregulloreje.
3. AKEP bazuar në raportet e CRDB për performancën e operatorëve në lidhje me zbatimin e afateve dhe rregullave të portimit si dhe në ankesat dhe mosmarrëveshjet e pajtimtarëve për portimin e numrit (përfshirë statistikën për ankesat) merr masa proporcionale për operatorët që nuk zbatojnë portabilitetin e numrit ose që rezultojnë me shkelje të përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
4. AKEP përcakton një person kontakti në strukturën e tij për ankesat e pajtimtarëve për portimin e numrit dhe ky person komunikon me personat përkatës të kontaktit të operatorëve për portabilitetin duke kryer dhe investigime për ankesat individuale të pajtimtarëve dhe veprimet e operatorëve.

Neni 24

Masat Administrative

1. **Në rastet e dështimit të sipërmarrësve, në përmbushjen e detyrimeve të portimit të numrit përcaktuara në nenet 126 dhe 145 të ligjit 54/2024 dhe të kësaj Rregulloreje, AKEP-i merr masa administrative në lidhje me mos-zbatimin e portabilitetit si dhe vonesat, abuzimin në procesin e portimit, sipas parashikimeve në nenin 184 të Ligjit 54/2024 dhe akteve nënligjore përkatëse.**
2. Në rast të mos shlyerjes **nga sipërmarrësi** të detyrimeve financiare të parashikuara në këtë Rregullore **sipërmarrësit i ndërpritet aksesit në CRDB** dhe aplikohet gjoja sipas parashikimit në paragrafin 1 të këtij neni.

KAPITULLI V

Dispozita të fundit

Neni 25

Shfuqizime

Rregullore nr. 43 “Për mënyrën e zbatimit Portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.2689, datë 22.09.2016, e ndryshuar, shfuqizohet në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues i AKEP dhe publikimit të saj në fagen e internetit të AKEP www.akep.al.

Neni 27

Dispozita Kalimtare

1. Detyrimi për zbatimin nga sipërmarrësit të përcaktimeve të kësaj Rregulloreje në lidhje me:
 - b. krijimin e statusit pezull në CRDB dhe pranimin me kusht të kërkesave për portim numri nga ODH;
 - c. detyrimet e ODH për procesimin e automatizuar të kërkesave për portimin e numrave të çaktivizuar
do të hyjnë në fuqi 6 muaj pas datës së miratimit të kësaj Rregulloreje.
2. Përcaktimet e dokumentit “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010 do të ngelen në fuqi, për aq sa nuk bien në kundërshtim me përcaktimet e kësaj Rregulloreje dhe aktet e tjera nënligjore të AKEP, deri në datën e miratimit/hyrjes në fuqi të dokumentit të specifikimeve teknike të miratara sipas kësaj Rregulloreje
3. Sipërmarrësit dhe operatori CRDB kanë detyrim që gjatë periudhës 6 mujore të referuar në pikën 1 të këtij neni, të marrin të gjitha masat e nevojshme teknike dhe operacionale në mënyrë që në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të kenë implementuar në sistemet dhe procedurat e brendshme të tyre të gjitha ndryshimet e nevojshme për zbatimin e të gjitha përcaktimeve të kësaj Rregulloreje.

ANEKS 1

Formulari i kërkeses për portim të numrit

Ky Aneks përmban informacionin minimal të formularit të kërkesës për portim për t'u përdorur nga operatori marrës, për numra Aktivë dhe të Çaktivizuar. Nëse aplikuesi kërkon të portojë disa numra njëkohësisht dhe midis tyre ka si Numra Aktivë dhe Numra të Çaktivizuar, këshillohet që të përdoren dy formularë të ndryshëm, një për Numrat Aktivë dhe një për Numrat e Çaktivizuar, pra në të njëjtin formular të mos përfshihen numra Aktivë dhe të Çaktivizuar.

Logo e OM		
1	Operatori Dhënës (ODH):	-
2	Operatori Marrës (OM):	
3	Numri/numrat e telefonit që kërkohet të barten nga ODH tek OM:	
4	Statusi aktual i numrit tek Operatori Dhënës:	
	4.1	☐ Aktiv
	4.2	☐ Çaktivizuar
5	Kategoria e Planit tarifar aktual të pajtimtarit tek ODH	
	5.1	☐ Parapagim
	5.2	☐ Paspagim/Hibrid (tarife mujore)
6	Kategoria e marrëdhënies kontraktore të pajtimtarit tek ODH:	
	6.1	☐ Personale/Individ (Konsumator)
	6.1.1	Emër Mbiemër:
	6.1.2	Numri Unik Personal:
	6.2	☐ Biznes (Subjekt fizik, subjekt juridik, Institucion etj, i regjistruar me NIPT tek ODH)
	6.2.1	Emri i Subjektit :
	6.2.2	NIPT
	6.2.3	Emri i personit të Autorizuar
	6.2.4	Numri Unik Personal i Personit të Autorizuar
7	Detaje të kontaktit të pajtimtarit për procesin e portimit	
	Numer Tel/Mob:	
	Email:	
8	Data dhe Ora e depozitimit të Kërkesës nga pajtimtari/aplikuesi te OM:	dd/mm/viti Ora: hh.mm
9	Data kur do të realizohet portimi/aktivizimi i numrit tek OM:	☐ Brenda 1 dite pune, ose ☐ Më datë dd/mm/viti Ora: hh.mm (ditë pune dhe brenda orarit 8.00-16.00)

Shënime:

Pajtimtari/aplikuesi pajiset nga OM me një kopje të printuar ose elektronike të formularit të plotësuar të kërkesës për portim.

Nëse Operatori Marrës dërgon kërkesën në sistemin CRDB në një datë të ndryshme nga data e depozimit të kërkesës nga pajtimtari tek OM, Operatori Marrës celular njofton me SMS pajtimtarin për datën e hedhjes në sistemin CRDB të kërkesës, e cila nuk do të jetë me vonë se 1 (një ditë) pune nga data e depozitimit të kërkesës nga pajtimtari

Unë, i nënshkruari/aplikuesi i kërkesës për portim numri, konfirmoj se jam informuar si më poshtë:

- a) Bartje e një numri të telefonit do të thotë që numri i plotë transferohet nga Operatori Dhënës (në vijim, ODH) tek Operatori Marrës (në vijim, OM). Si pajtimtar i një shërbimi publik telefonik/komunikimit zanor kam të drejtën të kërkoj bartjen e numrit dhe që të dy, ODH dhe OM janë të detyruar të mbështesin këtë proces. Unë kërkoj bartjen e numrit nëpërmjet nënshkrimit të këtij formulari të kërkesës për portim tek OM, i cili udhëheq procesin e bartjes dhe duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të bartur numrin. Operatori Marrës do të më njoftojë për ecurinë e procesit të bartjes në çdo fazë të tij.
- b) **Kërkesa për bartje të një Numri Aktiv përbën kërkesë për mbyllje të kontratës ekzistuese me ODH, dhe realizimi i bartjes së numrit do të përfundojë automatikisht kontratën ekzistuese që kam me ODH, por nuk do t'i përfundojë detyrimet e mia me ODH sipas kontratës ekzistuese (apo të kontratës së mëparshme nëse kërkesa për portim është për një Numër të Çaktivizuar nga ODH), në rast se kam detyrime të tilla dhe që duhen paguar/përbushur sipas njoftimit/njoftimeve përkatëse të ODH.**
Nëse kam ndonjë pyetje lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe ndonjë pagesë tjetër të mundshme ndaj ODH, këto çështje duhet t'i sqaroj në kontakt të drejtpërdrejtë me ODH.
- c) OM është i detyruar të më informojë lidhur me detajet e kushteve të kontratës sime të re, në veçanti lidhur me çdo detyrim që unë duhet t'i paguaj OM dhe nëse unë mund të përdor pajisjet ekzistuese në rrjetin e OM.
- d) OM do më njoftojë (me SMS për operatorët celularë) për datën e hedhjes në sistemin CRDB të kërkesës për bartje (nëse kjo datë është e ndryshme nga data e depozitimit të kërkesës sime tek OM) dhe unë nuk mund të kërkoj anulimin e procesit të bartjes së numrit pasi kërkesa është hedhur në sistemin CRDB.
- e) Nëse kam ndonjë pyetje tjetër lidhur me kushtet ose tarifat e kontratës së re me OM, do t'i sqaroj këto çështje në kontakt të drejtpërdrejtë me OM para nënshkrimit të këtij dokumenti.

Deklaroj si më poshtë:

1. **Kjo kërkesë për portim numri nga ODH tek OM, është këkesë për portim të një Numri Aktiv (të Çaktivizuar) që aktualisht kam në përdorim (kam pasur në përdorim) si pajtimtar i ODH.**
2. Dëshiroj të nënshkruaj kontratë me OM sipas termave dhe kushteve kontraktore, përfshirë tarifave të shërbimeve të cilat më janë paraqitur nga OM në dokumente të veçanta.
3. Dëshiroj që të dy operatorët të bashkëpunojnë dhe të bartin numrin e përmendur nga ODH tek OM në kohën e kërkuar. Autorizoj OM, që në emrin tim, të ri-drejttojë kërkesën time ODH **për portimin e Numrit Aktiv dhe mbylljen e kontratës time ekzistuese për këtë numër ose portimin e Numrit të Çaktivizuar.**

Pjattimtar/Aplikuesi:
Emër Mbiemër, Nënshkrimi

Përfaqesuesi i Operatorit Marrës:
Emër Mbiemër, Nënshkrimi dhe
Vula e OM

Vendi dhe data_____

SHTOJCA 1: Shpjegues për Dokumentin për Këshillim Publik


1. Konteksti

Portabiliteti i numrit është një lehtësi apo mundësi për të gjithë përdoruesit fundorë që janë pajtimtarë të shërbimit publik telefonik të pajisur me numra nga Plan i Kombëtar i Numeracionit që të ruajnë numrat e tyre, sipas kërkesës, kur ata ndërrojnë sipërmarrësin që u ofron shërbimin publik telefonik dhe shërbime të tjera të lidhura me numrin e telefonit. E drejta e portimit të numrit dhe zbatimi me efektivitet i saj konsiderohet një faktor i rëndësishëm për maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike pasi portimi i numrit (ruajtja e numrit) të telefonit lehtëson procesin e zgjedhjes dhe ndërrimit të ofruesit të shërbimit të komunikimeve elektronike për pajtimtarët si dhe njëkohësisht nxit konkurrencën efektive midis ofruesve të shërbimeve në tregun e komunikimeve elektronike.

Portabiliteti i numrit nisi të zbatohet në Shqipëri në vitin 2011 sipas përcaktimeve të neneve 87-88 të ligjit 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore përkatëse të nxjerra nga AKEP në vitin 2010, të cilat përfshinin Rregulloren nr. 13/2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr.1219, datë 07.04.2010, si dhe dokumentin, “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010, nëpërmjet të cilit u kryen dhe procedurat përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave referencë të centralizuar të portabilitetit (CRDB).

Portimi i numrave për pajtimtarët e rrjeteve dhe shërbimeve publike telefonike të lëvizshme filloi në vitin 2011, ndërsa për pajtimtarët e rrjeteve dhe shërbimeve publike telefonike fikse filloi në vitin 2012. Deri në fund të vitit 2024 rezulton se janë portuar në total rreth 1.3 milionë numra celularë dhe rreth 20 mijë numra fiks. Sic është referuar dhe Raportin vjetor të AKEP 2024, në vitet e fundit është vënë re një reduktim i ndjeshëm si sasisë së numrave të portuar dhe në vitin 2024 u portuan 19,452 numra celularë dhe 173 numra fiks, që përbën një reduktim me 50% të portimeve në krahasim me vitin 2023, si dhe nivelet më të ulëta historike të sasisë vjetore të numrave të portuar prej fillimit të zbatimit të portabilitetit të numrit në Shqipëri (2011/2012).

Ecuria e sasive të numrave të portuar 2012-2024




Rregullorja nr.13/2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, ka qenë objekt i disa ndryshimeve ndër vite, dhe në vitin 2016 u zëvendësua me Rregulloren nr. 43/2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.2689, datë 22.09.2016.

AKEP në vitin 2018 kreu disa ndryshime në Rregulloren nr.43/2016 që synonin përmirësimin e procesit të portimit të numrit për të adresuar kryesisht problematikat e evidentuara në lidhje me përqindjen e lartë të refuzimit të kërkesave për portim të numrit celular për shkak të mospërputhjes së ID. Këto ndryshime patën efekt pozitiv në reduktimin e ndjeshëm të përqindjes së refuzimeve në periudhën 2018-2019, por në periudhën 2020-2024 është vënë re një rritje ndjeshme e numrit të ankesave të pajtimtarëve të lidhura me portimin e numrit celular, si dhe një rritje sërish të përqindjes së kërkesave të refuzuara nga operatorët celularë.


Ndërkohë gjatë vitit 2024 dhe tremujorit të parë 2025 është vënë re një rënie e ndjeshme e numrit të ankesave të pajtimtarëve për refuzim të kërkesave për portim numri celular nga ODH, duke arritur në rreth 50 ankesa T2 2024 – T1 2024, krahasuar me pikun prej rreth 500 ankesa në T2 2023.

Gjatë së njëjtës periudhë edhe përqindja e kërkesave për portim të refuzuara nga ODH celular ka rezultuar në rënie, por me ritme më të moderuara duke arritur në rreth 50% refuzime në T1 2025 krahasuar me 60-70% refuzime në vitin 2023, ku One ka pasur reduktimin më të madh me 19 pikë përqindje, ndërsa Vodafone reduktim me 9 pikë përqindje. Pavarësisht këtyre reduktimeve, niveli rreth 50% i kërkesave për portim të refuzuara nga operatorët celularë është ende shumë i lartë, krahasuar dhe me nivelin më të ulët të refuzimeve prej rreth 30% të arritur në vitin 2019.

Ecuria e numrit të ankesave për refuzim të kërkesave për portim numri celular T1_2023 -T1_2025



Ecuria e përqindjes së kërkesave për portim të refuzuara nga operatori dhënës 2016-T1_2025



Problematikat në lidhje me portabilitetin

Problematikat e raportuara në ankesat e pajtimtarëve lidhen me refuzimet e kërkesave për portim të numrit nga operatori transferues, për arsye të mospërputhjes së ID së përdoruesve me parapagim në sistemet e operatorit dhënës/transferues me ID në kërkesën për portim të dërguar nga operatori marrës/përfitues dhe detyrimeve kontraktore që pajtimtari me paspagim ka ndaj

operatorit dhënës/transferues, dhe të cilat duhet t'i shlyejë përpara portimit të numrit (kalimit dhe aktivizimit të numrit tek operatori marrës dhe çaktivizimit të numrit nga operatori dhënës.

Kuvendi i RSH nëpërmjet rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP për vitin 2023, ka rekomanduar që AKEP gjatë vitit 2024 krahas proceseve të monitorimit/inspektimit të zbatimit nga operatorët të detyrimeve dhe rekomandimeve të lëna në inspektimet e mëparshme, të rishikojë Rregulloren e Portabilitetit duke synuar përmirësimin e procesit të portimit, veçanërisht përmes vendosjes së detyrimeve dhe përgjegjësiave edhe për operatorin dhënës për informimin e pajtimtarit për arsyet e refuzimit të kërkesës për portim.

Pavarësisht proceseve të monitorimit/inspektimit dhe masave administrative dhe rekomandimeve të AKEP ndaj operatorëve celularë, si dhe rënies së numrit të ankesave të pajtimtarëve gjatë vitit 2024 (shiko Raporti vjetor I AKEP 2024) dhe tremujorin e parë 2025, Projekt-Rregullorja përmban ndryshime nga Rregullorja 43/2016 që AKEP i ka konsideruar të nevojshme për adresimin e problematikave të evidentuara për refuzimin e kërkesave për portim të numrit celular.

Ndryshimi ligjit te komunikimeve elektronike

Ligji nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar Ligjin 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji i ri 54/2024 ka përafuar pjesërisht në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (në vijim EECC), dhe përmban një sërë përcaktimesh të reja në lidhje me portabilitetin e numrit, të cilat nuk kanë qenë pjesë e Ligjit 9918/2008.

Ligji 54/2024 në Nenet 126, 145, 146 dhe 180 përmban përcaktime mbi të drejtat e përdoruesve fundorë dhe detyrimet e sipërmarrësve në lidhje me portimin e numrit dhe ndërrimin e ofruesit të shërbimit nga përdoruesit fundorë, një pjesë e të cilave nuk kanë qenë pjesë e përcaktimeve të Ligjit 9918/2008 ose kuadrit nënligjor përkatës ekzistues. Këto përcaktime të reja të Ligjit 54/2024 në lidhje me portabilitetin e numrit dhe ndërrimin e ofruesit të shërbimit, përfshijnë ndër të tjera:

- Përcaktimet në pikat 1-3 të Nenit 145 në lidhje me ndërrimin e ofruesit të shërbimit të aksesit në internet të cilat synojnë garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi për përdoruesin fundor në rastet e ndërrimit të ofruesit të shërbimit, që ky proces të kryhet brenda një kohe sa më të shkurtër dhe mungesa e shërbimit për përdoruesin fundor gjatë këtij procesi të mos jetë më e gjatë se një ditë pune;

- Përcaktimet në pikën 5 të nenit 145:

Kur një përdorues përfundon një kontratë, ai ruan të drejtën për portimin e një numri nga Plani Kombëtar i Numeracionit të një ofrues tjetër, për të paktën një muaj nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme, përveç rastit kur përdoruesi fundor heq dore nga kjo e drejtë.

- Përcaktimet në pikën 12 të nenit 145:

Në rastin e dështimit të procesit të portimit, ofruesi transferues riaktivizon numrin dhe shërbimet e lidhura për përdoruesin fundor deri në portimin e suksesshëm të numrit. Ofruesi transferues vazhdon ofrimin e shërbimeve të tij me të njëjtat kushte dhe terma

derisa shërbimet në ofruesin marrës të jenë aktivizuar. Në çdo rast, ndërprerja e shërbimit gjatë procesit të mbartjes nuk do të jetë më e gjatë se një ditë pune. **Operatorët e rrjetit të aksesit apo faciliteteve të tyre që përdoren nga ofruesi dhënës apo marrës** ose nga të dy bashkë, marrin masa për kryerjen pa vonesa të portimit dhe sigurimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje për përdoruesin.

- Përcaktimet në pikat 15 dhe 16 të Nenit 145:

15. Ofruesit transferues, sipas kërkesës dhe kur është e mundur teknikisht, rimbursen konsumatorët për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim. Ofruesi mund të aplikojë një tarifë për rimbursimin vetëm kur ajo parashikohet në kontratë. Tarifa për rimbursimin duhet të jetë proporcionale dhe në raportin e duhur ndaj kostove aktuale të sipërmarrësit transferues për ofrimin e rimbursimit.

16. AKEP-i, bazuar në specifikat e tregut shqiptar të komunikimeve elektronike dhe pas një procesi konsultimi për mundësitë teknike, miraton me rregullore mënyrat për kompensimin e përdoruesve fundorë nga ofruesit, sipas pikës 15 të këtij neni, me qëllim sigurimin e kompensimit, në mënyrë të thjeshtë dhe duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- Përcaktimet në pikën 17 të nenit 145, dhe pikat 1/c/ii dhe 1/c/iii të Nenit 180 të ligjit 54/2024:

1. Ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik, të disponueshëm për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit, të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë me makinë, do të ofrojnë në kontratë informacionin, si më poshtë:

c) informacion për kohëzgjatjen e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e kontratës, duke përfshirë tarifat e mundshme të përfundimit, në masën që këto kushte zbatohen:

- i. çdo përdorim ose kohëzgjatje minimale që kërkohet për të përfituar nga kushtet promociionale;
- ii. çdo tarifë në lidhje me ndërrimin dhe marrëveshjet e kompensimit dhe rimbursimit për vonesën ose abuzim të ndërrimit, si dhe informacion në lidhje me procedurat përkatëse;
- iii. informacion për të drejtën e konsumatorëve që përdorin shërbimet e parapaguara për një rimbursim, sipas kërkesës të çdo kredie të mbetur në rast ndërrimi, siç përcaktohet në nenin 145 të këtij ligji;

Neni 146 (Zbatimi i portabilitetit të numrit) i Ligjit 54/2024 përcakton se:

1. AKEP-i nëpërmjet një rregulloreje të veçantë përcakton mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit dhe afatet kohore përkatëse.
2. Në hartimin e rregullores së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i duhet të ketë parasysh kërkesat e nenit 145 të këtij ligji.

Sa më sipër, Rregullorja 43/2016 ka nevojë të rishikohet për të reflektuar përcaktimet e reja në lidhje me portabilitetin e numrit të Ligjit 54/2024 si dhe për të adresuar problematikat e raportuara nga pajtimtarët dhe ato të evidentuara nga AKEP.

2. Ndryshimet e Projekt-Rregullores me Rregulloren nr.43/2016 dhe Pyetjet e Këshillimit Publik

Ndryshimet kryesore midis “Projekt-Rregullores Për mënyrën zbatimin e portabilitetit të numrit” (në vijim Projekt-Rregullore) dhe rregullores aktuale në fuqi për portabilitetin e numrit, Rregullore nr.43/2016 “Për mënyrën zbatimin e portabilitetit të numrit”, e ndryshuar (në vijim, Rregullore 43/2016), mund të grupohen në dy grupe:

- Ndryshime për të reflektuar bazën e re ligjore (Ligjin 54/2024), përfshirë terminologjinë dhe përcaktimet e reja të këtij ligji në lidhje me portabilitetin e numrit, që nuk kane qenë pjesë e Ligjit 9918/2008 apo Rregullores 43/2016,
- Ndryshime që synojnë adresimin e problematikave të raportuara nga pajtimtarët dhe/ose të evidentuara nga AKEP në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim nga operatorët dhënës, të përfshira dhe në Rekomandimin nr 2. të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për AKEP.

Projekt-Rregullorja është hartuar bazuar në strukturën e Rregullores 43/2016 dhe ndryshimet kryesore midis dy dokumentave janë dhënë me tekst në ngjyrë të theksuar (bold) dhe nënvizuar (underlined), dhe në disa raste në Projekt-Rregullore është përdorur numërtim me fraksion i neneve apo pikave të neneve, për lehtësi të lexuesit.

Në nën-seksionet e mëposhtme AKEP ka dhënë shpjegime për ndryshimet kryesore të propozuara si dhe ka përfshirë në fund të çdo nën-seksioni pyetje për këshillim publik për çështjet më të rëndësishme që janë objekt i ndryshimeve të propozuara.

- **Ndryshimet për reflektim të përcaktimeve të reja të ligjit 54/2024 për portabilitetin e numrit**

2.1 Përkufizimet/termat e reja të Ligjit 54/2024

Në Projekt-Rregullore AKEP ka reflektuar ndryshimet në termat dhe përkufizimet e përdorur në Ligjin 54/2024 në krahasim me Ligjin 9918/2008 dhe Rregulloren 43/2016, Këto ndryshime janë reflektuar në Nenin 4 (Përkufizime dhe Shkurtime) të Projekt-Rregullores për termat e mëposhtëm:

- Operator/ofrues i komunikimeve elektronike publike
- Operator/Ofrues Dhënës dhe Operator/Ofrues Marrës
- Operator i rrjetit të aksesit
- Rrjeti dhënës (në vijim referuar dhe si rrjeti i ODH

Ligji 54/2024 në nenin 145 përdor disa terma të rinj si Ofruesi Tranferrues, Sipërmarrësi Transferrues dhe Ofruesi Dhënës, Ofruesi Marrës dhe Operator i rrjetit të aksesit, të cilat janë sipas përcaktimeve të EECC, duke përfshirë në detyrimet për portabilitetin e numrit si ODH dhe/ose OM dhe ofrues të shërbimeve të komunikimeve elektronike të cilët ofrojnë shërbime të komunikimit elektronik për pajtimtarët duke përdorur rrjetin e aksesit dhe/ose facilitetet shoqëruese të këtij rrjeti të një sipërmarrësi tjetër.

Përcaktimet në pikën 12 të Nenit 145, në lidhje me detyrime për procesin e portimit dhe për operatorët e rrjetit të aksesit apo faciliteteve të tyre që përdoren nga ofruesi dhënës apo marrës ose nga të dy bashkë mund të jenë të aplikueshme në rastet e MVNO-ve (Mobile Virtual Netëork Operator) apo MVNE-ve (Mobile Virtual Netëork Enabler) të cilët përdorin përdorin rrjetet e

aksesit të MNO-ve ose ofruesit e shërbimit të telefonisë fikse nëpërmjet rrjetit të aksesit të një operatori operatori/sipërmarrësi tjetër fikse, me/ose pa detyrime për FNT për LLU (local loop unbundling). Këta ofrues shërbimesh në proceset e portimit të numrave, për aktivizimin dhe/ose çaktivizimin e numrave të portuar (si edhe për numrat jo të portuar) të pajtimtarëve të tyre varen nga operatori përkatës i rrjetit të aksesit, dhe ky i fundit duhet të veprojë në përpuhje me përcaktimet e pikës 12 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024⁸ të refelktuara në Projekt-Rregullore (Neni 4, pika 5/1 dhe Neni 19, pika 7), duke bashkëpunuar me ODH/OM pa shkaktuar vonesa për procesin e portimit të numrave.

AKEP thekson se pavarësisht përcaktimeve të mësipërme, përgjegjësia kryesore për respektimin e afateve për portimin e numrit është e ODH dhe OM që janë ofruesit e shërbimit të pajtimtarit (para dhe pas portimit), dhe ata duhet të bashkëpunojnë dhe japin udhëzimet përkatëse operatorit të rrjetit të aksesit për cdo proces portimi, sipas dhe marrëveshjes përkatëse të aksesit, me qëllim që të garantojnë zbatimin e afateve të Ligjit 54/2024 dhe Rregullores së portabilitet për portimin e numrave të pajtimtarëve të tyre.

Përvec termave të mësipërm, në Projekt-Rregullore janë përdorur dhe termat *shërbime të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra*, *shërbim publik telefonik* dhe *shërbim komunikimi zanor (me zë)*, të cilët kanë të njëjtin kuptim si në përkufizimet e Nenit 4 të Ligjit 54/2024.

Termet “*shërbim publik telefonik*” dhe “*shërbim komunikimi zanor*”, përdoren në mënyrë të ndërylltë në Projekt-Rregullore, pasi pavarësisht se në Ligjin 54/2024 janë përkufizuar si terma të ndryshëm, bazuar në preambulën nr.14 të EECC,⁹ termi “*shërbim publik telefonik*” i përdorur në Direktivat e vitit 2022 shpesh i perceptuar si shërbimi tradicional analog telefonik (Circuit switching) duhet zëvendësuar me termin “*Shërbim komunikimi zanor*” që është term më aktual dhe teknologjikisht neutral (përfshin dhe komunikimet të bazuar në teknologjinë protokolleve të internetit (packet switching)).

Pyetje nr.1:

A jeni dakord me ndryshimet dhe/ose shtesat e propozuara për përkufizimet e termave në pikat 1, 5, 5/1, 6, 6/1, 6/2, 7 dhe 7/1 të Nenit 4 të Projekt-Rregullores?

2.2 Fusha e zbatimit dhe parime të përgjithshme

AKEP në Nenin 5 të Projekt-Rregullores ka kryer disa ndryshime në krahasim me Rregulloren 43/2016, për të refektuar përcaktimet e Nenit 126 të Ligjit 54/2024 si dhe për të saktësuar fushën e zbatimit të përcaktimeve të Rregullores, në lidhje me kategoritë e numrave që mund të jenë objekt i kërkesës për portim.

Neni 126 I Ligjit 54/2024 parashikon që përdoruesit fundor kanë të drejtë të kërkojnë portim të numrave që ata kanë nga të gjitha kategoritë e numrave (gjeografikë dhe jogjeografikë) nga plani kombëtar i numeracionit.

⁸ Operatorët e rrjetit të aksesit apo faciliteteve të tyre që përdoren nga ofruesi dhënës apo marrës ose nga të dy bashkë, marrin masa për kryerjen pa vonesa të portimit dhe sigurimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje për përdoruesin.

⁹ Definitions need to be adjusted to ensure that they are in line with the principle of technology neutrality and to keep pace with technological development, including new forms of network management such as through software emulation or software-defined networks. Technological and market evolution has brought networks to move to internet protocol (IP) technology, and enabled end-users to choose between a range of competing voice service providers. Therefore, the term ‘publicly available telephone service’, which is exclusively used in Directive 2002/22/EC and widely perceived as referring to traditional analogue telephone services, should be replaced by the more current and technological neutral term ‘voice communications service’

AKEP në Nenin 5 të Projekt-Rregullores ka përcaktuar që

*Kjo Rregullore zbatohet vetëm për portabilitetin e **numrave të caktuar përdoruesve fundorë/pajtimtarëve nga sipërmarrësit për përdorim për shërbim publik telefonik/komunikim zanor** që i përkasin kategorive të mëposhtëme të numrave në PKN:*

- *numra gjeografikë (në vijim numra fiks) sipas përkufizimit në pikën 25 të Nenit 4 të Ligjit 54/2024;*
- ***numra jogjeografikë të lëvizshëm** (në vijim numra të lëvizshëm) sipas përkufizimit në pikën 26/a të Nenit 4 të Ligjit 54/2024.*

Përcaktimet e mësipërme janë në përputhje dhe me pikat 6 dhe 7 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024:

*6. Të gjithë **sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike** fikse janë të detyruar të **mundësojnë portabilitetin e numrit gjeografik**, për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin që u ofron shërbimin publik telefonik fiks.*

*7. Të gjithë **sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike të lëvizshme** janë të detyruar të **mundësojnë portabilitetin e numrit jogjeografik** për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik të lëvizshëm.*

Sa më sipër, AKEP sqaron se përcaktimet e Projekt-Rregullores (si edhe të Rregullores 43/2016) nuk zbatohen për:

- portabilitetin e numrave gjeografikë në vendndodhje të ndryshme gjeografike (portabilitet gjeografik i numrave fiks)
- portabilitetin e numrave midis për ndryshim shërbimi nga shërbim nga rrjet fiks në shërbim nga rrjet i lëvizshëm (portabilitet i shërbimit)
- portabilitetin e numrave të përdorur për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike që nuk janë shërbime të komunikimit ndërpersonal sipas përkufizimit të Ligjit 54/2024 të tilla si numrat e përdorur për komunikimet M2M, pasi këto nuk janë komunikime ndërpersonale apo shërbim publik telefonik/komunikim zanor.
- portabilitetin e numrave jogjeografikë që janë numra të kategorive të përcaktuara në nën-pikat b-d, pika 26 e Nenit 4 të Ligjit 54/2024 si numrat për shërbimet me vlerë të shtuar/me tarifë premium; numrat 0800 xxxx; numrat për shërbim publik telefonik nomadik.

Ndërkohë, portimi i numrave (fiks ose celular) të përdorur për komunikimet M2M mund të kryhet me marrëveshje vullnetare midis ODH dhe OM.

Ndërsa për portabilitetin e numrave të tjerë, AKEP do të vlerësojë përcaktimin e rregullave shtesë në një kohë të mëvonshme, për shkak dhe të proceseve më të ndërlikuara për portabilitetin e këtyre numrave. Aktualisht për numrat jo-gjeografike si numrat 0800 që alokohen nga AKEP direkt për përdoruesit fundorë (alokim parësor), përdoruesit e tyre nuk kanë nevojë për të drejtë portimi/portabilitet pasi ata zotërojnë të drejtën e përdorimit të numrit (si ofrusit/operatorët që pajisen me të drejtë përdorimi nga AKEP për numrat fiks dhe të lëvizshëm) dhe kanë mundësinë e zgjedhje së operatorit të rrjetit se ku do të hostojnë këto numra, dhe ndryshimit të mëpashëm të tyre. AKEP do të vlerësojë mundësitë për ndryshime në mënyrën e alokimit të këtyre numrave, për të alokuar numrat 0800 vetëm operatorëve të rrjeteve (alokim parësor), dhe alokimi (dytësor) për përdoruesit fundorë i numrave 0800 (apo dhe kategori të tjera) të kryhet vetëm nga operatorët e rrjeteve që kanë marrë grupe/seri nga këto numra nga AKEP.

Pyetje nr.2:

A jeni dakord me ndryshimet në Nenin 4 (Fusha e Zbatimit dhe Parime të përgjithshme) të Projekt-Rregullores?

Pyetja nr.3:

Cili është opiniononi juaj në lidhje me sqarimet e dhëna nga AKEP në këtë shpjegues në lidhje me portabilitetin e numrave gjeografikë në vendndodhje të ndryshme gjeografike, portabilitetin e numrave të përdorur për komunikime M2M, portabilitetin e numrave 0800 etj.?

2.3 E drejta/mundësia e bartjes së numrit nga pajtimtari/përdoruesi fundor

Sipas pikës 5 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024:

5. Kur një përdorues përfundon një kontratë, ai ruan të drejtën për portimin e një numri nga Plani Kombëtar i Numeracionit të një ofrues tjetër, për të paktën një muaj nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme, përveç rastit kur përdoruesi fundor heq dore nga kjo e drejtë.

Përcaktimi i mësipërm përbën një ndryshim të rëndësishëm në lidhje me të drejtën e përdoruesit fundor/pajtimtarit për të portuar numrin, pasi sipas përcaktimeve të Rregullores 43/2016, pajtimtari ka të drejtë të kërkojë portimin e numrit vetëm nëse numri është aktiv në rrjetin e operatorit dhënës me të cilin pajtimtari ka një kontratë pajtimi të vlefshme, e cila mund të jetë me plan tarifar me parapagim dhe/ose paspagim, me afat të caktuar dhe/ose afat të pacaktuar (ka përfunduar afati fillestar i caktuar p.sh. 12 apo 24 muaj dhe kontrata vijon me afat të pacaktuar).

E drejta e pajtimtarit/detyrimi i ODH për të portuar vetëm numrat aktivë (humbja e së drejtë pasi numri ka kaluar në status “Çaktivizuar”) është pjesë e një sërë parashikimeve në Rregulloren 43/2016, përfshirë:

- Neni 5, pika 6: *Vetëm numrat të cilat janë Aktivë sipas përkufizimit në këtë Rregullore (neni 4, pika 12) mund të barten.*
- Neni 13, pika 2: *Për të pasur mundësinë e portimit të numrit, pajtimtari duhet të jetë në zotërim të një Numri Aktiv telefonik sipas përkufizimit në nenin 4, pika 12 si dhe të ketë plotësuar kushtin e përcaktuar në pikën 7 të nenit 16 të kësaj Rregulloreje.*
- Neni 15, pika 2: *Operatori Dhënës nuk është i detyruar të eksportojë numrin nëse ky numër nuk është Aktiv sipas përcaktimit në nenin 4, pika 12 e kësaj rregulloreje, apo edhe nëse është aktiv ky numër ka më pak se 3 muaj që është bartur në rrjetin e tij.*
- Neni 18, pika 4/iv:
Kur Operatori Dhënës merr një kërkesë për bartje, do të kontrollojë i.nëse numri që do të bartet është aktiv (sipas përcaktimeve në këtë rregullore) në rrjetin e Operatorit Dhënës

....

Kontrolli/verifikimi nga ODH duhet të jetë plotësisht automatik në databazën e pajtimtarëve të tij (me parapagim dhe paspagim) për fushat e mëposhtme:

...

Statusi (aktiv/caktizuar)...

- Neni 18, pika 5/c/ii: *Kërkesa për portim mund të refuzohet nga ODH pasi: numri i cili do të bartet nuk është Aktiv sipas përkufizimit në këtë Rregullore*

Sa më sipër, del e nevojshme që ruajtja e së drejtës së pajtimtarit/përdoruesit fundor për të portuar një numër pas datës së përfundimit të kontratës së mëparshme me ODH sipas pikës 5 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024 të reflektohet në Projekt-Rregullore, si dhe të përcaktohet një afat kohor i caktuar/maksimal se për sa kohë mund të ushtrohet kjo e drejtë nga pajtimtari, pasi pika 5 e Nenit 145 të Ligjit 54/2024 ka përcaktuar vetëm afatin minimal të ruajtjes së të drejtës për

portim (të paktën një muaj) nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme.

Një aspekt tjetër i lidhur me afatin e së të drejtës së pajtimtarit për të portuar numrin sipas Rregullores 43/2016 është dhe detyrimi për pajtimtarin që pasi ka portuar numrin të qëndrojë të paktën 3 muaj tek operatori i ri në mënyrë që të bëjë kërkesë për të portuar numrin sërish (ri-portim) tek operatori i mëparshëm apo tek një operator tjetër. Ky përcaktim është e pjesë e Nenit 15, pika 2 (më sipër) dhe në Nenin 16, pika 7 të Rregullores 43/2016:

- Neni 16, pika 7: *Pajtimtarit i lind e drejta e bartjes përsëri të numrit vetëm 3 muaj pasi është bartur në rrjetin e ODH.*

Përcaktimi i një periudhe kohore për lindjen e së drejtës së ri-portimit është bërë me qëllim për të parandaluar komunikimet e ODH me pajtimtarin që ka bërë kërkesë për portim apo sa është portuar që të rikthehet tek ODH nëpërmjet ofertave/bonuseve të individualizuara, që nuk janë të disponueshme për pajtimtarët e tjerë (ëin-back) si dhe për shmangur proceset e portimeve tepër të shpeshta të pajtimtarëve nga një operator tek tjetri, të cilat megjithëse mund të sjellin përfitime afatshkurtra për këta pajtimtarë, rrisin kostot e përgjithshme të portabilitetit dhe operatorëve si dhe reduktojnë përfitimet afatgjatë për pajtimtarët.

Megjithatë sipas Rregullores 43/2016 ky afat nuk aplikohet për portimin për herë të parë të numrit, dhe një pajtimtar i pajisur më një numër ka të drejtë të bëjë kërkesë për portim edhe brenda ditës. Në konsultimin publik dhe diskutimet për ndryshimet e Rregullores 43/2016 të kryera në vitin 2018, operatorët kryesorë kanë kërkuar që afati 3 muaj të aplikohet dhe për portimet për herë të parë, por kjo kërkesë nuk u reflektua në Rregulloren 43/2016. AKEP vlerëson se rregullimi aktual është jo-simetrik dhe afati 3 muaj (apo cdo afat tjetër) ose duhet të aplikohet në të dy rastet ose në asnjë prej rasteve.

Sa më sipër, AKEP propozon që periudha aktuale 3 mujore e lindjes të së drejtës së ri-portimit të një numri aktiv të aplikohet edhe për të drejtën e portimit për herë të parë të një numri aktiv nga pajtimtari, si edhe për ruajtjen e së të drejtës së portimit të një numri të caktizuar. AKEP vlerëson se ky rregullim është simetrik dhe proporcional pasi:

- Rregullimi aktual është jo-simetrik dhe afati 3 muaj (apo cdo afat tjetër) për lindjen e së drejtës për ri-portim të numrit aktiv ose duhet të aplikohet edhe për lindjen e së drejtës për portim për herë të parë ose në asnjë prej këtyre rasteve;
- Rregullimi i propozuar siguron simetri në afatet e lindjes së të drejtës për portim për herë të parë të numrit Aktiv, lindjes së drejtës për portim sërish (ri-portim) numri Aktiv, dhe ruajtjen e së drejtës për portim të numrit të Çaktivizuar, dhe një pajtimtar me numër të portuar apo pa-portuar do ketë mundësinë e portimit të numrit 3 muaj pas aktivizimit për herë të parë tek ODH, ri-portimit të numrit, si dhe do e ruajë të drejtën e portimit deri në 3 muaj pas çaktivizimit të numrit nga operatori dhënës.

Sa më sipër, AKEP ka reflektuar në Projekt-Rregullore përcaktimet e pikës 5 të nenit 145 të Ligjit 54/2024 si dhe propozimin e mësipërm për afatin 3 muaj të lindjes së të drejtës për portim, ri-portim numri aktiv dhe ruajtje të së drejtës për portim numri të çaktivizuar. Këto ndryshime janë përfshirë në Nenin 16, pika 17 të Projekt-Rregullores, si më poshtë:

Pajtimtarit i lind e drejta e bartjes së numrit vetëm 3 muaj pasi është bërë pajtimtar i operatorit dhënës (nëpërmjet pajisjes/aktivizimit të shërbimeve me një numër të ri nga operatori dhënës apo nëpërmjet bartjes së numrit nga një operator dhënës tjetër), dhe e ruan të drejtën për portimin e këtij numri si përdorues fundor i mëparshëm i tij deri në 3 muaj pas datës së përfundimit të kontratës/çaktivizimit të numrit nga ODH.

Pajtimtari/përdoruesi fundor ka të drejtë të kërkojë portimin e një Numri Aktiv që aktualisht është në përdorim të tij tek ODH ose të një Numri të Çaktivizuar që ka qenë në përdorim të tij tek ODH, sipas afateve të mëposhtme:

- Numër Aktiv: jo më herët se 3 muaj nga data që është bërë pajtimtar i ODH (data e aktivizimit për herë të parë të numrit tek ODH si numër i ri apo i portuar nga /ODHF)
- Numër i Çaktivizuar: jo më vonë se 3 muaj nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme/çaktivizimit të numrit nga ODH, përveç rasteve kur përdoruesi fundor ka hequr dorë në mënyrë të shprehur nga kjo e drejtë.

(Shënim: Numri Aktiv/Çaktivizuar që kërkohet të portohet mund të jetë një numër që është aktivizuar për herë të parë si numër i ri tek ODH (ODHF) ose numër i portuar më parë tek ODH nga një operator tjetër dhënës).

Ndryshimet e mësipërme janë reflektuar në një sërë përcaktimesh të tjera të Projekt-Rregullores si: Pikat 12 dhe 13 të Nenit 4; Pika 2 e Nenit 13; Pika 2 e Nenit 15; Pika 4 dhe Pika 5 e Nenit 18, Formulari në Aneks 1, etj.

Në lidhje me implementimin e ndryshimeve të mësipërme për ruajtjen e së drejtës për portim të numrit sipas pikës 5 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024 (**Kur një përdorues përfundon një kontratë, ai ruan të drejtën për portimin e një numri nga Plani Kombëtar i Numeracionit të një ofrues tjetër, për të paktën një muaj nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme, përveç rastit kur përdoruesi fundor heq dorë nga kjo e drejtë**), AKEP sqaron gjithashtu sa më poshtë:

- **Kur një përdorues përfundon një kontratë dhe data e përfundimit të kontratës së mëparshme**

AKEP ka lidhur datën e përfundimit të kontratës me datën e çaktivizimit (përfundimtar) të numrit të pajtimtarit nga operatori sipas përkufizimit në pikën 13 të Nenit 4 të Projekt-Rregullores, dhe përfundimi i kontratës/çaktivizimi i numrit mund të jetë bërë me kërkesë të pajtimtarit dhe/ose nga operatori në zbatim të kushteve të kontratës (p.sh ka përfunduar afati I kontratës me paspagim dhe/ose parapagim) sipas

Data e përfundimit të kontratës dhe afati maksimal 3 muaj për ruajtjen e së drejtës së portimit, nuk duhet të konsiderohet data kur përfundon afati i një kontrate me afat të caktuar (e cila sipas përcaktimeve aktuale të kontratave të pajtimtarit zakonisht kalon në kontratë me afat të pacaktuar pas njoftimeve përkatëse nga Operatori), por do të konsiderohet data kur numri është çaktivizuar plotësisht/përfundimisht nga ODH, sipas përkufizimit të dhënë në pikën 13 të Nenit 4 të Projekt-Rregullores. Pra rastet kur numri që është objekt i kërkesës për portim ka përfunduar kontratën me afat të caktuar dhe ka kaluar në kontratë me afat të pacaktuar, apo një numër me plan tarifar me parapagim është në status joaktiv pasi nuk ka bërë rimbushje, apo shërbimi për një numër me paspagim është kufizuar apo ndërprerë përkohësisht për shkak të mospagesës, nuk do të konsiderohen si numra të Çaktivizuar në kuptim të Projekt-Rregullores (pika

13, Neni 4), por numra Aktivë sipas përcaktimit në pikën 12, Neni 4 të Projekt-rregullores;

- ***përveç rastit kur përdoruesi fundor heq dore nga kjo e drejtë***

Pajtimtari/përdoruesi fundor nuk e ruan të drejtën për portim pasi numri ka kaluar në status të Çaktivizuar vetëm në rastet kur ky pajtimtar/përdorues fundor në përfundim të kontratës ka hequr dorë në mënyrë të shprehur/mjet të qëndrueshëm nga kjo e drejtë, dhe ODH zotëron prova të heqjes dorë nga kjo e drejtë e pajtimtarit/përdoruesit fundor të mëparshëm të numrit. Pajtimtarë aktuale dhe të mëvonshëm që nuk kanë hequr dorë në mënyrë të shprehur dhe/ose për të cilët ODH nuk ka prova me mjet të qëndrueshëm të heqjes dorë nga ruajtja e së drejtës për portim, do të kenë mundësinë ta ruajnë këtë drejtë sipas afateve të dhënë në Projekt-Rregullore.

Ndryshimet e mësipërme për ruajtjen e së drejtës së pajtimtarit për të portuar një numër të çaktivizuar nga ODH, përbëjnë ndryshim të rëndësishëm dhe me impakt në proceset e breshme të operatorëve si ODH, përfshirë databazën e pajtimtarëve të referuar në Pikën 4/iv të Nenit 18, ku ODH përveç statusit të numrit (Aktiv/Çaktivizuar) duhet të ruajë dhe datën e Çaktivizimit të numrit, dhe kjo datë do të shërbejë për llogaritjen e afatit 3 mujor të cituar më sipër.

Deklarimi i statusit të numrit (Aktiv/Çaktivizuar) nga pajtimtari/aplikuesi është përfshirë dhe në formularin e kërkesës për portim, me qëllim lehtësimin e proceseve të verifikimit nga ODH.

Pyetje nr.4:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me përcaktimet e reja në Nenin 16, pika 17 të Projekt-Rregullore për ruajtjen e së drejtës së portimit të numri pas përfundimit të kontratës?

Pyetje nr.5:

A jeni dakord me propozimin e AKEP për vendosjen e afatit simetrik 3 mujor për:

- *lindjes së të drejtës për ri-portim numri aktiv (përcaktim aktual i Rregullores 43/4016)*
- *lindjes së të drejtës për portim për herë të numrit aktiv;*
- *ruajtjen e së drejtës për portim të numrit të çaktivizuar (Ligji 54/2024 përcakton vetëm afatin minimal Të paktën 1 muaj)?*

2.4 E drejta e pajtimtarëve me parapagim për rimbursim të kreditve të papërdorura

Sipas përcaktimeve në pikat 15 dhe 16 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024:

15. Ofruesit transferues, sipas kërkesës dhe kur është e mundur teknikisht, rimbursin konsumatorët për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim. Ofruesi mund të aplikojë një tarifë për rimbursimin vetëm kur ajo parashikohet në kontratë. Tarifa për rimbursimin duhet të jetë proporcionale dhe në raportin e duhur ndaj kostove aktuale të sipërmarrësit transferues për ofrimin e rimbursimit.

16. AKEP-i, bazuar në specifikat e tregut shqiptar të komunikimeve elektronike dhe pas një procesi konsultimi për mundësitë teknike, miraton me rregullore mënyrat për kompensimin e përdoruesve fundorë nga ofruesit, sipas pikës 15 të këtij neni, me qëllim sigurimin e kompensimit, në mënyrë të thjeshtë dhe duke respektuar kërkesat e legjisllacionit në fuqi.

Përcaktimet e mësipërme vendosin detyrime ndaj operatorit dhënës/ofruesit transferues për rimbursim, sipas kërkesës, të pajtimtarëve të kategorisë konsumatorë për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim (aktualisht me portimin e numrit tek një operator tjetër, pajtimtari i humbet kreditet e papërdorura me parapagim te operatori i mëparshëm/ODH).

Për reflektimin e parashikimeve të Pikave 15 dhe 16 të Nenit 145 të Ligjit 54/2025, AKEP ka përfshirë në Projekt-Rregullore një nen të vecantë, Neni 22 *Rimbursimi i krediteve të papërdorura të shërbimit me parapagim*, në të cilin janë propozuar afatet përkatëse për dorëzimin e kërkesës nga pajtimtarët (jo më pak se 14 ditë nga portimi i numrit) për rimbursim tek ODH dhe trajtimin e këtyre kërkesave nga ODH (3 ditë pune për informimin për kërkesën dhe 30 ditë për të kryer rimbursimin), përfshirë tarifën maksimale administrative që mund të aplikojë ODH (500 lek me TVSH, si dhe mënyrat e rimbursimit nga ODH).

Neni 22

Rimbursimi i krediteve të papërdorura të shërbimit me parapagim

1. Pajtimtarët e kategorisë konsumator që janë përdorues me parapagim të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike (të lëvizshme) kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim nga ODH për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në datën e ndërprerjes së shërbimit nga ODH/datën e portimit të numrit.
2. ODH kryen rimbursimin e konsumatorit sipas përcaktimeve në kontratën ekzistuese me pajtimtarin dhe procedurave përkatëse për rimbursim, të hartuara dhe publikuara në përputhje me përcaktimet e pikës 1/c/iii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024, procedura të cilat duhet të jenë të thjeshta dhe në përputhje me përcaktimet e këtij neni dhe legjislacionit në fuqi.
3. ODH ka detyrim të kryejë rimbursimin e konsumatorit për kreditet e mbetura **në bazë të kërkesës** së konsumatorit me parapagim të depozituar tek ODH brenda një afati të arsyeshëm të caktuar nga ODH në procedurat e rimbursimit, **afat i cili nuk duhet të jetë më pak se 14 ditë kalendarike nga data e portimit të numrit**. ODH duhet të ofrojë mundësinë e paraqitjes së kërkesës për rimbursim nga konsumatorët në pikat e shitjes së ODH, si edhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike online (p.sh email ose kërkesa të depozitura online) që ODH mund të përdorë në marrëdhëniet me pajtimtarët dhe që mundësojnë identifikimin e pajtimtarit nga ODH.
4. ODH ka të drejtë të aplikojë një tarifë administrative për procesimin e kërkesës për rimbursimin vetëm kur ajo parashikohet në kontratën ekzistuese të ODH me konsumatorin. Tarifa e aplikuar në këto raste duhet të jetë proporcionale dhe në raportin e duhur ndaj kostove aktuale të ODH për ofrimin e rimbursimit. **Tarifa administrative për rimbursim** duhet të jetë fikse dhe e pavaruar nga vlera e rimbursuar, por në cdo rast **jo më e lartë se 500 lekë (me TVSH)**.
5. Kredite të rimbursueshme të pajtimtarit me parapagim sipas pikës 1 më sipër, do të jetë vlera monetare e krediteve të parapaguara nga pajtimtari konsumator, të cilat janë të vlefshme për t'u përdorur apo vlera e mbetur e tyre në llogarinë e përdoruesit me parapagim (gjendja/balanca e mbetur e llogarisë me parapagim) në momentin e ndërprerjes së shërbimit nga ODH për shkak të portimit të numrit drejt OM. Në këtë vlerë nuk përfshihen kreditet e përdorura tashmë për blerje të ofertave/paketave me parapagim dhe as vlera e krediteve të ofruar nga ODH si bonus apo promocion për pajtimtarin.
6. ODH kryen rimbursimin e konsumatorit duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi, në një nga mënyrat e mëposhtme të pagesës:
 - Pagesë në Cash në një pikë shitje të ODH, ose
 - Pagesë me transfertë bankare nëse kjo kërkohet nga konsumatori sipas detajeve bankare të dhëna nga konsumatori në kërkesën për rimbursim.
7. ODH kryen rimbursimin e konsumatorit brenda një afati të arsyeshëm, por **jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për rimbursim**.
8. ODH, brenda 3 ditëve pune nga marrja e kërkesës për rimbursim, njofton konsumatorin me mjet të qëndrueshëm (SMS për kërkesat e paraqitura në pikën e shitjes të ODH dhe email për kërkesat e paraqitura me email ose online) duke e informuar në lidhje me:
 - Vlerën dhe mënyrën e rimbursimit, në rast se kërkesa për rimbursim është e vlefshme; ose

- Arsyen e mospranimit të kërkeës për rimbursim (p.sh kërkesa është depozituar jashtë afatit sipas pikës 3 më sipër, dhe/ose konsumatori aplikues për rimbursim nuk ka kredite të mbetura të vlefshme në datën e ndërprerjes së shërbimit/portimit të numrit).

AKEP sqaron se Neni 22 i Projekt-Rregullores përmban afate minimale dhe/ose maksimale, dhe afatet dhe procedurat e përkatëse, përfshirë tarifën administrative për rimbursim (jo më e madhe se 500 lekë me TVSH) duhet të përcaktohen nga secili operator (dhënës) në termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve të publikuara dhe në faqet përkatëse të internetit.

Pyetje nr.6:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me përcaktimet e Nenit 22 të Projekt-Rregullores për Rimbursimi nga ODH të krediteve të papërdorura të shërbimit me parapagim të hartuara nga AKEP në zbatim të pikave 15 dhe 16 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024?

Pyetje nr.7:

A jeni dakord me afatet, pracedurat dhe tarifën maksimale (500 Lekë me TVSH) që mund të aplikojë ODH për rastet e rimbursimeve të pajtimtarëve për kreditet e papërdorura të shërbimit me parapagim?

2.5 E drejta për kompensim e pajtimtarit nga ODH/OM në rast voneseva/abuzimeve me portimin

Sipas përcaktimeve në pikat 1/c/ii dhe 1/c/iii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024:

1.Ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik, të disponueshëm për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit, të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë me makinë, do të ofrojnë në kontratë informacionin, si më poshtë:

c) informacion për kohëzgjatjen e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e kontratës, duke përfshirë tarifën e mundshme të përfundimit, në masën që këto kushte zbatohen:

i. çdo përdorim ose kohëzgjatje minimale që kërkohet për të përfutur nga kushtet promocionale;

ii. çdo tarifë në lidhje me ndërrimin dhe marrëveshjet e kompensimit dhe rimbursimit për vonesën ose abuzim të ndërrimit, si dhe informacion në lidhje me procedurat përkatëse;

iii. informacion për të drejtën e konsumatorëve që përdorin shërbimet e parapaguara për një rimbursim, sipas kërkesës të çdo kredie të mbetur në rast ndërrimi, siç përcaktohet në nenin 145 të këtij ligji;

Përcaktimi në pikën 1/c/ii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024 është detyrim për operatorët për të përfshirë në kontratën e pajtimit informacion në lidhje me procedurat e kompensimit dhe rimbursimit në rastet e vonesave ose abuzimeve me procesin e ndërrimit të operatorit ofrues të shërbimit, që sipas Nenit 145 mund të jenë dy raste:

- Ndërrim i ofruesit të shërbimit të aksesit në internet (pikat 1-3);
- Ndërrim i ofruesit të shërbimit publik telefonik me portim numri (pika 4-18).

Për sa i përket vonesave dhe abuzimeve me procesin e portimit të numrit, ato mund të kryhen nga ODH dhe/ose OM si vonesa në afatet e portimit të numrit të lidhura me çaktivizimin/aktivizimin e numrit nga ODH/OM, refuzimet pa arsye të justifikueshme nga ODH të kërkesave, tejkalim të afateve të hedhjes/përgjigjes së kërkesave në CRDB nga OM/ODH, portim pa kërkesë të pajtimtarit nga OM etj.

Ndërsa përcaktimet e pikës 1/c/iii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024 janë të lidhura me pikat 15-16 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024, dhe përmbajnë detyrime për ODH të reflektuara në Nenin 22 të Projekt-Rregullores (shiko më sipër), përcaktimet në pikën 1/c/ii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024

(që janë të aplikueshme për ODH dhe/ose OM), AKEP i ka reflektuar duke shtuar në Projekt-Rregullore Nenin 22/1 Kompensimi në rast të vonesave ose abuzimeve me procesin portimi.¹⁰

Neni 22/1

Kompensimi në rast të vonesave ose abuzimeve me procesin portimi

1. ODH/OM ka detyrim të kompensojë dhe/ose rimburojë pajtimtarin për vonesat dhe/ose abuzimet e kryera nga ODH/OM në procesin e portimit të numrit sipas përcaktimeve në kontratën aktuale të ODH/kontratën e re të OM me pajtimtarin dhe procedurave përkatëse për kompensimin dhe rimbursimin në rast vonese ose abuzimi gjatë procesit të ndërrimit të ofruesit të shërbimit/portimit të numrit, të hartuara dhe publikuara nga OM në përputhje me përcaktimet e pikës 1/c/ii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024 dhe aktet nënligjore të AKEP të nxjerra në zbatim të Ligjit 54/2024.
2. Vonesat dhe/ose abuzimet të kryera nga ODH/OM në procesin e portimit të numrit do të konsiderohen:
 - Kryerja e procesi portimi të numrit nga OM pa kërkesë nga pajtimtari;
 - Refuzim/pranim me kusht i kërkesës për portim numri nga ODH në kundërshtim me përcaktimet e kësaj Rregulloreje;
 - Tejkallim i afateve nga ODH në përgjigje për kërkesë për portim;
 - Tejkallimi i afateve nga OM për hedhjen në CRDB të kërkesës për portim.

Pyetje nr.8:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me përcaktimet e Nenit 22/1 të Projekt-Rregullores për kompensimet e pajtimtarit nga ODH dhe/ose OM në rast të vonesave ose abuzimeve me procesin e portimit të numrit?

Pyetje nr.9:

A mendoni se AKEP vlerat e kompensimit për pajtimtarin sipas Nenit 22/1 të Projekt Rregullores duhet të përcaktohen nga secili operator (si ODH dhe/ose OM) në termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrsimit të shërbimit apo duhet që AKEP të përcaktojë këto vlera të kompesimit?

Nëse PO, çfarë vlerash do të sugjeronit në varësi të vonesës dhe/ose abuzimit nga ODH/OM me procesin e portimit të numrit?

- **Ndryshimet për adresim të problematikave të raportuara nga pajtimtarët dhe/ose të evidentuara nga AKEP**

2.6 Detyrime kontraktore/Pranimi me Kusht/Statusi Pezull/Njoftimet e ODH për pajtimtarin

Sic është përshkruar në seksionin pararendës Konteksti të këtij dokumenti për këshillim publik si dhe raportet vjetore të AKEP, problematikat kryesore të raportuara në ankesat e pajtimtarëve di dhe të evidentuara nga AKEP lidhen me refuzimet e kërkesave për portim të numrit nga operatori dhënës celular, për arsye të:

- mospërputhjes së ID së përdoruesve me parapagim në sistemet e operatorit dhënës/transferues me ID në kërkesën për portim të dërguar nga operatori marrës/përfitues dhe
- detyrimeve kontraktore që pajtimtari me paspagim ka ndaj operatorit dhënës/transferues, dhe të cilat duhet t'í shlyejë përpara portimit të numrit (kalimit dhe aktivizimit të numrit tek operatori marrës dhe çaktivizimit të numrit nga operatori dhënës.

¹⁰ Neni 106 i EECC i transpozuar pjesërisht në Nenin 145 të Ligjit 54/2024, në pikën 8 citon:

Member States shall lay down rules on the compensation of end-users by their providers in an easy and timely manner in the case of the failure of a provider to comply with the obligations laid down in this Article, as well as in the case of delays in, or abuses of, porting and switching processes, and missed service and installation appointments.

Për të adresuar problematikat e evidentuara, si dhe për të përmbushur dhe Rekomandimin e Kuvendit të RSH, AKEP ka propozuar një sërë ndryshimesh në Projekt-Rregullore në krahasim me Rregulloren 43/2016, të cilat përfshijnë:

- zëvendësimin e **përgjigjes negative** të ODH se **kërkesa për bartje pranohet por nuk mund të ekzekutohet** sepse ky numër ka detyrime të papaguara/papërmbushura sipas kontratës ekzistuese me përgjigjen **Pranim me Kusht** pasi pajtimtari/përdoruesi fundor që ka bërë kërkesën për portim ka detyrime të papërmbushura sipas kontratës ekzistuese (kur kërkesa është për portim Numër Aktiv) ose të mëparshme (kur kërkesa është për portim Numër i Çaktivizuar).
- krijimin e statusit Pezull në CRDB për kërkesat që janë Miratuar me Kusht (vetëm për pajtimtaërt me paspagim) dhe qëndrimin në këtë status të kërkesës deri sa pajtimtari të shlyejë detyrimet përkatëse tek ODH, por jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e krijimit të këtij statusi;
- vendosjen e detyrimeve dhe afateve përkatëse për operatorin dhënës (ODH) për komunikimin dhe informimin e pajtimtarit në lidhje me arsyen e refuzimit të kërkesës për portim, duke i dërguar njëkohësisht pajtimtarit nëpërmjet SMS-së dhe Numrin Unik Personal të regjistruar te ODH (për rastet e refuzimit për shkak të ID), ose vlerën monetare të detyrimit kontraktor që duhet të paguajë pajtimtari që të vijojë me portimin e numrit (në rast të refuzimit të kërkesës për detyrime kontraktore të pashlyera);
 - aktualisht pajtimtari informohet nga OM vetëm për refuzimin dhe arsyen e refuzimit të kërkesës nga ODH, pa përfshirë informim të ID aktuale të regjistruar tek apo vlerës së detyrimit ndja ODH;
- saktësime të disa termave kryesore të lidhura me detyrimet kontraktore të pajtimtarit për të shmatur/minimizuar interpretimet e ndryshme midis pajtimtarit, ODH dhe OM:
 - “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”
 - “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”:

Ndryshimet e mësipërme janë reflektuar në një sërë përcaktimesh të Projekt-Rregullores, ku më kryesoret janë bërë në Nenet 4, 15 dhe 18 të Rregullores 43/2016, të përshkrura në vijim.

Nëni 4 Përkufizime dhe Shkurtime

Janë shtuar përkufizimet 17-20 si më poshtë:

17. “Miratim/pranim me kusht”: është është përgjigja e ODH për kërkesën për portim të një numri me plan tarifor me paspagim në rastet se nga procesi i verifikimit rezulton se pajtimtari është debitor apo ka detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës ekzistuese me ODH për numrin që do të bartet (sipas pikës 19 më poshtë).
18. “Status pezull”: është statusi i krijuar në sistemin CRDB për një kërkesë për portim për një numër celular ose fiks e cila është miratuar me kusht nga ODH.
19. “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”: janë detyrimet financiare të pajtimtarit ndaj ODH, pagesa/përmbushja e të cilave është e nevojshme të kryhet përpara miratimit të kërkesës për portim të numrit nga ODH, të cilat mund të përfshijnë sipas rastit:
 - a. Detyrime për faturat e lëshuara nga ODH (përfshirë detyrimet e prapambetura të mundshme - që u ka kaluar afati i pagesës - dhe faturën e muajit aktual/ mëparshëm) dhe të papaguara nga pajtimtari deri në datën e marrjes së kërkesës për bartje nga ODH nëpërmjet CRDB/datën e pranimit me kusht të kërkesës;
 - b. Detyrimi për përdorimin e shërbimit gjatë muajit aktual sipas faturës të lëshuar/që mund të lëshohet nga ODH deri në datën e njoftimit të pranimit me kusht të kërkesës për portim ose në datën e pagesës nga pajtimtari së detyrimeve të referuara në këtë paragraf (pikat a dhe c);

- c. Penalitete¹¹ dhe/ose kompensime financiare¹² te aplikueshme për pajtimtarin në rast të përfundimit para afatit minimal të kontratës me afat të caktuar sipas përcaktimeve të nenit 144 të Ligjit 54/2024.
20. “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”: janë detyrimet që mund të përmbushen nga pajtimtari vetëm në datën e përfundimit të kontratës ose pas kësaj date, dhe të cilat mund të përfshijnë sipas rastit:
- a. Detyrimi për pagesën e faturës së lëshuar nga ODH për tarifimin e aplikueshëm për marrjen/përdorimin e shërbimit pas datës së fundit të periudhës së faturuar deri në datën e realizimit të portimit të numrit/ndërprerjes së shërbimit nga ODH/, nëse shërbimet e përfituara nga pajtimtari gjatë kësaj periudhe nuk janë ose janë pjesërisht të përfshira në faturën e fundit të lëshuar nga ODH (pika 19/a ose 19/b më sipër);
- b. Kthimi i pajisjes fundore të përfshirë në paketën tarifore të integruar ose kompensimi për pajisjen në rast të moskthimit të saj brenda afatit të caktuar nga ODH sipas kontratës ekzistuese (jo më herët se data e ndërprerjes së shërbimit nga ODH).

Neni 15 Detyrimet e Operatorit Dhënës

Janë shtuar pikat 9-12 me tekstin e mëposhtëm:

9. ODH ka të drejtë të pranojë me kusht një kërkesë për portim numri të pajtimtarit me paspagim vetëm nëse pajtimtari, në datën e marrjes së kërkesës për bartje nga ODH nëpërmjet CRDB/datën e pranimi me kusht të kërkesës, rezulton me “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” sipas pikës 19 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje.

ODH, në “Detyrimet kontraktore për t’u përmbushur nga pajtimtari përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”, nuk mund të përfshijë detyrime të tjera shtesë, përveç atyre të specifikuara në kontratën ekzistuese midis ODH dhe pajtimtarit për shërbimin që përfshin numrin që do të bartet, dhe që janë të aplikueshme në rast të zgjidhjes/përfundimit të kontratës me kërkesë të pajtimtarit sipas përcaktimeve të nenit 144 të Ligjit 54/2024 dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme.

Detyrimet kontraktore për t’u përmbushur nga pajtimtari me/pas përfundimit të kontratës/portimit të numrit, sipas pikës 20 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje, nuk përbëjnë kriter për pranimin me kusht të një kërkesë për portim të një Numri Aktiv. Këto detyrime mund paguhen/përmbushen nga pajtimtari vetëm në datën e përfundimit të kontratës/ndërprerjes së shërbimit nga ODH ose pas kësaj date sipas njoftimit përkatës te ODH.

ODH ka të drejtë të pranojë me kusht një kërkesë për portim të një pajtimtari të mëparshëm me paspagim për një Numër të Çaktivizuar vetëm nëse pajtimtari/përdoruesi fundor, në datën e marrjes së kërkesës për bartje nga ODH nëpërmjet CRDB/datën e pranimi me kusht të kërkesës, rezultoni me detyrime të papërmbushura sipas kontratës së mëparshme me ODH (mund të jetë cdo lloj i detyrimi i papërmbushur sipas pikave pika 19 dhe 20 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje).

10. ODH ka detyrim të pranojë kërkesën për portim të numrit të pajtimtarit nëse asnjë prej kriterëve të refuzimit dhe pranimi me kusht nuk plotësohen.
11. ODH në rastet e refuzimit të kërkesave për portim numri për shkak të mos-përputhjes së ID/NIPT ose pranimi me kusht të kërkesës për portim të një numri me paspagim, njofton dhe informon pajtimtarin me mjet të qëndrueshëm komunikimi (SMS për operatorët celularë) si dhe kryen veprimet dhe proceset pëkatëse për saktësimin e ID dhe/ose realizimin e portimit të numrit sipas kërkesave dhe afateve specifikuara në pikat 12/b, 13 dhe 14 të Nenit 18 të kësaj Rregulloreje.
12. ODH pas datës së portimit/ndërprerjes së shërbimit ka të drejtë të faturojë pajtimtarin me paspagim vetëm për “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”, të cilat janë detyrime

¹¹ Penalitet/tarifë për zgjidhje të parakohshme të kontratës me afat të caktuar sipas pikës 1/c/iv të Nenit 180 të Ligjit 54/2024 (pika 2 e Nenit 18 të Rregullores 49/2021). Ky penalitet nuk është i aplikueshëm në rastet e parashikuara në pikat 6, 8, 9 dhe 10 dhe 11, të nenit 144 të ligjit 54/2024.

¹² Kompensim për pajisje fundore: Detyrimet e mbetura për pajisjet fundore të subvencionuara/ të përfshira në paketën tarifore të integruar, në momentin e lidhjes së kontratës (sipas pikave 11 dhe 12 të Nenit 144 të Ligjit 54/2024).

shtesë të lindura gjatë statusit pezull, të cilat nuk janë përfshirë në faturimin e “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”, ose që mund përmbushen nga pajtimtari vetëm pas ndërprerjes së shërbimit/kontratës nga ODH si kthimi i pajisjes fundore.

Neni 18 Kërkesa dhe përgjigja për bartje

Në pikën 5, të Nenit 18 është hequr përgjigja negative e ODH se **kërkesa për bartje pranohet por nuk mund të ekzekutohet** (pika 5/c/v) dhe zëvendësuar me përgjigjen **Pranim me Kusht**, të shtuar si paragraph më vehte (Neni 18, pika 5/d) si më poshtë:

5/d: në rast të përgjigjes për Pranim me Kusht të kërkesës për portim, (ODH përfshin) arsyen që pajtimtari/përdoruesi fundor që ka bërë kërkesën për portim ka detyrime të papërmbushura sipas kontratës ekzistuese (kur kërkesa është për portim Numër Aktiv) ose të mëparshme (kur kërkesa është për portim Numër i Çaktivizuar).

Përgjigja nga ODH për Pranimin me Kusht të kërkesës për portim aplikohet vetëm për pajtimtarë me paspagim në rastet kur pajtimtari/përdoruesi fundor i numrit që ka bërë kërkesën për portim:

- për një Numër Aktiv ka detyrime të papërmbushura sipas kontratës ekzistuese vetëm për “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” sipas pikës 19 të Nenit 4 të kësaj Rregullorje
- për një Numër të Çaktivizuar ka detyrime të papërmbushura sipas kontratës së mëparshme me ODH (mund të jetë cdo lloj i detyrimi i papërmbushur sipas pikave pika 19 dhe 20 të Nenit 4 të kësaj Rregullorje).

Përgjigja e ODH për Pranim me Kusht dërgohet në CRDB, ku krijohet Statusi Pezull dhe OM njoftohet se kërkesa është Pranuar me Kusht dhe kalon në Statusin Pezull.

Kërkesa për portim do të qëndrojë në Statusin Pezull deri sa pajtimtari të shlyejë detyrimet përkatëse tek ODH, por jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e krijimit të këtij statusi.

Me përmbushjen e detyrimeve të pajtimtarit, ODH pranon kërkesën për bartje, duke njoftuar OM nëpërmjet sistemit CRDB, dhe kërkesa kalon nga Statusi Pezull në Status të Pranuar dhe më pas vijojnë proceset përkatëse për realizimin e portimit të numrit.

Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga pajtimtari/mosdërgimit të mesazhit të pranimit të kërkesës nga ODH brenda afatit maksimal 30 ditor të Statusit Pezull, rasti mbyllet nga CRDB dhe kërkesa konsiderohet e Refuzuar.

Në pikën 12, të Nenit 18,

- Nënpiakat 12/a dhe b të Rregullores 43/2016 janë bashkaur në një nënpikë të vetme (12/a) për noftim të pajtimtarit nga OM;
- Është shtuar nënpika 12/b për njoftim dhe informim të pajtimtarit nga ODH në rast refuzimi të kërkesës ëpr portim:

12/b) ODH, jo më vonë se 8 orë/1 (një) ditë pune nga refuzimi i kërkesës për bartje për shkak të mospërbashkimit të ID/NIPT ose nga pranimi me kusht i kërkesës për bartje, njofton dhe informon pajtimtarin (me SMS për operatorët celularë) për arsyen/arsyet e refuzimit apo pranimit me kusht të kërkesës për portim të numrit, duke përfshirë në këtë njoftim edhe:

i. Në rast të refuzimit për shkak të mos-përbashkimit të ID/NIPT:

- Numrin Personal të Identifikimit (NIPT për pajtimtarët Biznes) të pajtimtarit i regjistruar tek ODH,
- Këshillën që pajtimtari të paraqitet në një nga pikat e shitjes së ODH, për të saktësuar të dhënat e identifikimit sipas formularit përkatës.

ii. Në rast të pranimit me kusht të kërkesës për shkak të detyrimeve të pajtimtarit me paspagim:

- Informimin për vlerën monetare totale dhe të detajuar të “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” sipas specifikimeve në pikën 19, neni 4 të kësaj Rregulloreje që pajtimtari duhet të paguajë si kusht për

pranimin e kërkesës për bartje nga ODH/ndërprerjen e kontratës me ODH, si dhe afatin maksimal për pagesën e këtyre detyrimeve, prej 28 ditë kalendarike nga data e njoftimit, si dhe që në rast mospagese të këtyre detyrimeve kërkesa për portim do të refuzohet dhe marrëdhëniet midis pajtimatrit dhe ODH do të vijnë sipas kontratës ekzistuese.

- Informimin për “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”, sipas specifikimeve në pikën 19, neni 4 të kësaj Rregulloreje, nëse ka, të tilla si faturimi për periudhën e mbetur deri në datën e ndërprerjes së kontratës/shërbimit nga ODH dhe/ose kthimi i pajisjes fundore të përfshirë në paketën tarifore të integruar ose kompensimi për pajisjen në rast të moskthimit të saj brenda afatit të caktuar nga ODH sipas kontratës ekzistuese (jo më herët se data e ndërprerjes së shërbimit nga ODH).

Pikat 13 dhe 14 të Nenit 18 Rregullores 43/2016 janë ndryshuar si më poshtë në Projekt-Rregullore:

17. Me paraqitjen e pajtimtarit tek ODH, sipas përcaktimeve në pikën 12/b më sipër, ODH:

- kryen identifikimin dhe saktësimin e të dhënave të pajtimtarit sipas ID dhe Numrit Personal të Identifikimit të paraqitur nga pajtimtari, nëpërmjet një dokumenti/mjeti të vlefshëm identifikimi, sipas formularit përkatës për këtë qëllim. ODH pajis pajtimtarin me një kopje të formularit të nënshkruar nga ODH.
- pajis pajtimtarin me faturën përkatëse për shlyerjen e “Detyrimeve kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” dhe/ose me mandat-pagesën (vërtetimi shlyerjes/pagesës së detyrimeve përkatëse).

18. ODH, menjëherë, apo maksimumi:

- brenda 1 (një) ore pune pas korrigjimit/saktësimit të të dhënave të identifikimit,
- brenda 4 orë pune pas pagesës nga pajtimtari në një nga pikat e shitjes së ODH (8 orë/1 ditë pune pas pagesës së kryer në rrugë bankare/dorëzimit të mandat pagesës bankare nga pajtimtari) të të gjitha “Detyrimeve kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit” (pika 19, neni 4 i kësaj Rregulloreje).

Pyetje nr.10:

Cili është opinionin juaj në lidhje me përkufizimet e termave të reja në pikat 19 dhe 20 të Nenit 4 të Projekt-Rregullores në lidhje me:

- “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”
- “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”?

Pyetje nr.11:

Cili është opinionin juaj në lidhje me përkufizimet e termave “Miratim/pranim me kusht” dhe “Status pezull” në pikat 17 dhe 18 të Nenit 4 të dhe me ndryshimet e tjera përkatëse në Nenet 15 dhe 18 të Projekt-Rregullore në lidhje me Pranimin me Kusht të kërkesave për portim numri me paspagim që ka detyrime për të përmbushur ndaj ODH dhe krijimin e Statusit Pezull në CRDB?

A mendoni se afati 30 ditë për Statusin Pezull është i arsyeshëm për pajtimtarin (përmbushje detyrimeve përkatëse) dhe procesin e portimit? Nëse jo, çfarë afati sugjeroni?

Pyetje Nr.12:

A jeni dakord me vendosjen e detyrimeve shtesë për ODH për njoftimin e pajtimtarit për arsyen e refuzimit të kërkesës për portim numri përfshirë informimin për ID dhe/ose vlerën detyrimet kontraktor të pajtimatrit ndaj ODH, sipas propozimeve në Nenet 15 (pika 11) dhe 18 (pika 12/b) të Projekt-Rregullores?

2.7 Disponueshmëria e CRDB dhe pagesat e operatorëve

Bazuar në pikën 2/l të Nenit 12 të Ligjit 54/2024, AKEP është përgjegjës për sigurimin e disponueshmërisë së një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e numrave.

Portabiliteti i numrit nisi të zbatohet në Shqipëri në vitin 2011 sipas përcaktimeve të neneve 87-88 të ligjit 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore përkatëse të nxjerra nga AKEP në vitin 2010, të cilat përfshinin Rregulloren nr. 13/2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr.1219, datë 07.04.2010, si dhe dokumentin, “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010, nëpërmjet të cilit u kryen dhe procedurat përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave referencë të centralizuar të portabilitetit (CRDB).

Rregullorja aktuale 43/2016 është miratuar në vitin 2026 duke zëvendësuar Rregulloren nr.13/2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, dhe në Nenin 10 përmban përcaktime në lidhje me sigurimin nga AKEP të disponueshmërisë së CRDB, e cila përfshin kryerjen e procedurave për të të garantuar dhe siguruar platformën dhe sistemet e operimit të CRDB, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e funksionimit të platformës dhe sistemeve të instaluar në CRDB (që kryhet nga operatori i CRDB) si dhe ambientet për hostimin e platformës dhe sistemeve të operimit të CRDB.

Neni 21 i Rregullores 43/2016 përmban përcaktime mbi mbulimin e kostove financiare të AKEP për sigurimin e disponueshmërisë së CRDB dhe pagesat e operatorëve që kryhen për AKEP për të mbuluar këto shpëenzime për portabilitetin.

AKEP ka kryer disa ndryshime në Nenin 10 (pikat 3-8) dhe në Nenin 21 (pikat 1-3) të Projekt-Rregullores që synojnë qartësim të proceseve/procedurave që kryen AKEP për sigurimin e disponueshmërisë së CRDB dhe funksionimin e saj si dhe financimin e shpenzimeve të AKEP nga pagesat e operatorëve për portabilitetin e numrit. Në këto ndryshime përfshihen:

- zëvendësimi i “*platforma dhe sistemet e operimit të instaluar në CRDB*” me “*platforma **(hardware)** dhe sistemet e operimit **(software)** të instaluar në CRDB **(për herë të parë dhe/ose përmirësime të mëvonshme të nevojshme)**;*
- Saktësime/rifolrmlim të pikës 3 në Nenin 10, në lidhje me sigurimin nga AKEP të disponueshmërisë së CRDB:

(Neni 10, pika 3): AKEP siguron disponueshmërinë e CRDB nëpërmjet kryerjes së procedurave përkatëse të prokurimit publik për të garantuar dhe siguruar:

- a) platformën (hardëare) dhe sistemet e operimit (softëare) të CRDB (për herë të parë dhe/ose përmirësime të mëvonshme të nevojshme);*
 - b) ambientet për hostimin e platformës dhe sistemeve të operimit të CRDB;*
 - c) shërbimin e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të funksionimit të platformës dhe sistemeve të instaluar në CRDB, që kryhet nga Operatori i CRDB.*
- përfshirja në Nenin 4, pika 2/1 e një përkufizimi për Operatorin e CRDB si dhe saktësime në Nenin 10 e përcaktimeve të mëposhtme:
 - **Kërkesat teknike për Operatorin e CRDB**, përfshirë ato për garantimin e kriterit të paanshmërisë dhe besueshmërisë, **parimin e mosdiskriminimit**, përcaktohen nga AKEP në dokumentin **“Specifikimet Teknike të Portabilitetit të Numrit” që miratohet me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP si dhe dokumentet përkatës të specifikimeve teknike/termave të referencës në procedurën e prokurimit publik të përzgjedhjes së Operatorit të CRDB;**
 - Operatori i CRDB është përgjegjës për operimin e platformës dhe garanton disponueshmërinë e funksioneve të bazës së të dhënave, **përfshirë zhvillimet e nevojshme softëarike (përfshirë**

teknike/operacionale) të nevojshme për ndryshimet në procesin e portabilitetit të numrit sipas përcaktimeve në këtë Rregullore dhe aktet e tjera përkatëse të AKEP në lidhje me portabilitetin e numrit

- përfshirja në Nenin 10, pika 8:

Pavarësisht paragrafit të mësipërm, dhe pikës 3/b të këtij Neni, për të garantuar dhe siguruar ambientet e hostimit të platformës dhe sistemeve të operimit të CRDB, AKEP mund të përdorë ambientet e veta dhe/ose të institucioneve publike të specializuara që garantojnë hostim të sigurt 24/7 dhe pa kosto shtesë apo me kosto shumë më të ulët se operatorët ekonomikë në treg.

- Saktësime në Nenin 21 në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të AKEP për sigurimin e disponueshmërisë së CRDB nëpërmjet pagesave të operatorëve të komunikimeve elektronike.

AKEP sqaron se ndryshimet e propozuara në Nenin 10 (pikat 3-8) dhe në Nenin 21 (pikat 1-3) nuk kanë asnjë efekt në skemën aktuale të sigurimit të disponueshmërisë së CRDB, ambienteve të hostimit, shërbimit të ofruar nga operatori i CRDB për mirëmbajtjen dhe funksionimin e CRDB, si dhe në pagesat që operatorët kryejnë aktualisht për AKEP për të financuar/mbuluar këto shpenzime për CRDB.

Pyetje nr.13:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me riformulimet në Nenin 10 (pikat 3-8) dhe në Nenin 21 (pikat 1-3) të Projekt-Rregullores në lidhje me sigurimin nga AKEP të disponueshmërisë së CRDB, ambienteve të hostimit, shërbimit të ofruar nga Operatori i CRDB për mirëmbajtjen dhe funksionimin e CRDB?

2.8 Formula për pagesat e operatorëve për disponueshmërinë e CRDB

Në lidhje me pagesat që operatorët kryejnë për AKEP për shpenzimet për sigurimin e disponueshmërisë së CRDB, formula aktuale e përcaktuar në pikën 3 të Nenit 21 të Rregullores 43/2016 dhe e pandryshuar në këtë propozim të Projekt-Rregullores (është bërë vetëm riformulim për qartësim të saj), bazohet në parimin e proporcionalitetit në bazë të Sasisë respektive të numrave të portuar (port-in)/të përfituar nga secili operator si OM në raport me sasinë totale të numrave portuar nga të gjithë operatorët gjatë vitit financiar/kalendarik të mëparshëm. Kjo formulë shpëndan kostot totale të disponueshmërisë së CRDB midis operatorëve në bazë sasisë së numrave (pajtimtarëve) të përfituar si OM.

Ndërkohë, përfitime nga CRDB nuk kanë vetëm operatorët që përfitojnë numra/pajtimtarë si OM, por edhe operatorët e tjerë të komunikimeve elektronike që përdorin dhe/ose kanë përfitim nga përdorimi i CRDB për informacionin e përfituar për numrat e bartur dhe përditësimin e LBPS-të tyre për rrugëzimin e thirrjeve drejt rrjetit/operatorit të duhur. CRDB u shërben të gjithë operatorëve të komunikimeve elektronike, ofrues të shërbimit publik telefonik për përdoruesit fundorë/pajtimtarë dhe ofrues të shërbimit të tranzitimit të thirrjeve, dhe CRDB komunikon cdo 6 orë me LBPS-të e të gjithë këtyre operatorëve që kanë detyrime të lidhen me CRDB por edhe përfitim nga kjo lidhje/akses (marrin informacion të përditësuar për cdo portim dhe të gjithë numrat e portuar), pavarësisht nëse përfitojnë ose jo numra si OM.

Sa më sipër, me qëllim aplikimin sa më të mirë të parimit të proporcionalitetit në raport me përfitimet e secilit operator nga disponueshmëria e CRDB dhe aksesin në CRDB, AKEP shtron për diskutim me palët e interesuara mundësinë që me akt të vecantë AKEP të përcaktojë dhe një tarifë fikse si detyrim vjetor për t'u paguar nga operatorët e komunikimeve elektronike për disponueshmërinë dhe aksesin në CRDB.

Kjo tarifë fikse vjetore propozohet të jetë e njëjtë për të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike, ofrues të shërbimit publik telefonik për përdoruesit fundorë/pajtimtarë dhe ofrues të shërbimit të tranzitimit të thirrjeve midis rrjeteve, që kanë detyrimin sipas Projekt-Rregullores (Nenet 6 dhe 8) të lidhen me CRDB (kanë përfituar akses) për mundësimin e portabilitetit të numrit dhe/ose përditësimin e informacionit për rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të portuar, pavarësisht nëse kanë përfituar ose jo numra si OM.

Të ardhurat që do të mblidhen nga kjo tarifë fikse apo shuma e faturuar nga AKEP për këtë tarifë fikse (kontribut fikse) për të gjithë operatorët (Tarifa fikse x Nr.operatorëve të faturuar) do të zbritet nga shpenzimet totale vjetore të AKEP për disponueshmërinë e CRDB, dhe diferenca (Totali i shpenzimeve – shumën e faturuar për Tarifën Fikse) do të përdoret nga AKEP për të llogaritur Koeficientin/koston për një numër të portuar dhe faturuar secilin operator në proporcion me sasinë e numrave të portuar (port-in) si OM sipas pikës 3/b të Nenit 21 të Projekt-Rregullores.

Pyetje nr.14:

Cili është opinioni juaj në lidhje me formulën aktuale për pagesat e operatorëve për disponueshmërinë e CRDB në proporcion me përfitimet në bazë të sasisë së numrave të portura (port-in) si OM (pika 3 e Nenit të 21 të Projekt-Rregullores dhe Rregullores 43/2016)?

A reflekton ajo kontribute sipas operatorëve në mënyrë të drejtë/proporcionale me përfitimet e të gjithë operatorëve nga aksesit në CRDB, për portim të numrave dhe rrugëzim të thirrjeve drejt numrave të portuar?

Pyetje Nr.15:

A jeni dakord me propozimin dhe shpjegimet e AKEP në seksionin “Formula për pagesat e operatorëve për disponueshmërinë e CRDB” të kësaj Shtojce, që AKEP me akt të vecantë (apo me një proces të vecantë këshillimi publik) të përcaktojë dhe një tarifë fikse vjetore e cila të jetë e njëjtë për të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike, ofrues të shërbimit publik telefonik për përdoruesit fundorë/pajtimtarë dhe ofrues të shërbimit të tranzitimit të thirrjeve midis rrjeteve, (pavarësisht nëse kanë përfituar ose jo numra si OM)?

Nëse PO, a mendoni se AKEP duhet të përfshijë mundësinë e vendosjes së tarifës fikse në Nenin 21 të versionit final Projekt-Rregullores dhe më pas të kryejë një proces të vecantë këshillimi publik?

2.9 Tarifat midis ODH dhe OM

AKEP në Nenin 21 të Projekt-Rregullores ka shtuar pikat 6 dhe 7 si më poshtë:

6.ODH dhe OM kanë detyrim që të mos aplikojnë për përdoruesit fundorë/pajtimtarët e tyre asnjë pagesë/tarifë direkte për shërbimin e portimit të numrit, përfaqëse tarifa nga ODH për ndryshim plani tarifor me paspagesë në paragim për pajtimtarë që kanë shprehur dëshirën për portim numri.

7.ODH ka të drejtë të aplikojë tarifë (me shumicë) ndaj OM për portimin e numrit, e cila paguhet nga OM sipas faturës përkatëse mujor, dhe kjo tarifë nuk duhet të jetë më e lartë se:

a. 500 Lek (pa TVSH)/ 600 Lek (me TVSH) për cdo numër të portuar me sukses nga ODH drejt OM

b. 250 Lek (pa TVSH)/ 300 Lek (me TVSH) për cdo kërkesë për portim numri të refuzuar për shkak të gabimeve (informacion i gabuar për ID, numër telefoni) në kërkesën për portim të OM të hedhur në CRDB (për kërkesat me shumë numra llogaritet në bazë të numrave të refuzuar)

Përcaktimet e mësipërme të pikës 6 dhe 7/a të Nenit 21 të Projekt-Rregullores janë riformulim i pikës 8 të Nenit 16 (Të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit) të Rregullores 43/2016, ndërsa pjesa e shtuar është pika 7/b.

AKEP propozon që krahas aplikimit të tarifës aktuale 500 Lek pa TVSH nga ODH për OM për cdo numër të portuar me sukses nga ODH tek OM (pika 7/a), ODH të ketë të drejtë të tarifojë OM dhe një tarife (250 Lek pa TVSH) për cdo kërkesë për portim jo të suksesshëm/të refuzuar

nga ODH për shkak të gabimeve (informacion i gabuar për ID, numër telefoni) në kërkesën për portim të OM. Ky propozim synon rritjen e përgjegjshmërisë së OM në hedhjen e kërkesave për portim, dhe reduktimin e kërkesave të shpeshta të njëpasnjëshme nga OM pavarësisht refuzimit nga ODH të kërkesës së parë për shkak të gabimeve në ID. Vendosija e një tarife për këto raste rrit njëkohësisht dhe përgjegjësinë e ODH për refuzimet për kërkesat për portim, pasi çdo kërkesë e refuzuar do jetë objekt i verifikimit të plotë nga OM për shkak të pasojave financiare nga refuzimi i kërkesës për OM.

Pyetje Nr.16:

A jeni dakord me me propozimin e AKEP në pikën 7/b të Nenit 21 të Projekt-Rregullores, që ODH të ketë të drejtë të tarifojë OM dhe një tarife (250 Lek pa TVSH) për çdo kërkesë për portim jo të suksesshëm/të refuzuar nga ODH për shkak të gabimeve (informacion i gabuar për ID, numër telefoni) në kërkesën për portim të OM?

Nwse PO, a është tarifa e propozuar 250 lekw pa TVSH e arsyeshme?

2.10 Formulari i kërkesës për portim numri

AKEP në Aneksin 1 të Projekt-Rregullore ka përfshirë formularin e kërkesës për portim të numrit i cili përmban informacion më të plotë në lidhje me numrin/numrat që kërkohet të portohen nga pajtimtari/aplikuesi sipas deklaratimit të pajtimatrit si Statusi i Numrit tek ODH (Aktiv/Çaktivizuar), kategoria e planit tarifar Parapagim/Pasapagim, detaje të personit të autorizuar për pajtimtarët e regjistruar si Biznes etj. AKEP gjithashtu ka bashkuar deklaratën në Aneksin 2 të Rregullores 43/2016 me Formularin në Aneks 1 të Projekt-Rregullores, duke reflektuar ndryshimet e propozuara në Projekt-Rregullore. Ndërkohë Aneksi 3 i Rregullores 43/2016 nuk është pjesë e anekseve të Projekt-Rregullores pasi ai është pjesë e kontratës së lidhur midis AKEP dhe Operatorit të CRDB.

Pyetje nr.17:

A jeni dakord me ndryshimet në Formularin e kërkesës për portim në Aneksin 1 të Projekt-Rregullores si dhe me bashkimin e Anekseve 1 dhe 2 të Rregullores 43/2016 në një Aneks të vetëm (Ankesin 1 në Projekt-Rregullore).

2.11 Implementimi i ndryshimeve të Rregullores së Portabilitetit

Përcaktimet e reja të Projekt-Rregullores përmbajnë një sërë ndryshimesh nga përcaktimet aktuale të Rregullores 43/2016, dhe miratimi i versionit final të Projekt-Rregullores pas procesit të këshillimit publik do të kërkojë nga operatorët implementimin e tyre sipas afateve të përcaktuara në versionin final të Rregullores.

Zbatimi nga operatorët i një pjesë të këtyre ndryshimeve do të kenë nevojë për ndryshime/përditësime në proceset e brendshme administrative, teknike dhe operacionale të operatorëve, si dhe implementim dhe sinkronizim të ndryshimeve sipas udhëzimeve të Operatorit të CRDB. Këto ndryshime që kërkojnë më shumë kohë për implementim dhe/ose bashkëveprim të operatorëve të komunikimeve elektronik dhe Operatorit të CRDB përfshijnë:

- krijimin e statusit pezull në CRDB dhe pranimin me kusht të kërkesave për portim numri nga ODH;
- detyrimet e ODH për procesimin e automatizuar të kërkesave për portimin e numrave të çaktivizuar.

Për sa më sipër, AKEP në Nenin 27 të Projekt-Rregullores ka parashikuar dispozita kalimtare, përfshirë implementimin e ndryshimeve të mësipërme brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e versionit final të Projekt-Rregullores që do miratohet nga AKEP pas procesit të këshillimit publik.

1. Detyrimi për zbatimin nga sipërmarrësit të përcaktimeve të kësaj Rregulloreje në lidhje me:
 - a. krijimin e statusit pezull në CRDB dhe pranimin me kusht të kërkesave për portim numri nga ODH;
 - b. detyrimet e ODH për procesimin e automatizuar të kërkesave për portimin e numrave të çaktivizuar
 do të hyjnë në fuqi 6 muaj pas datës së miratimit të kësaj Rregulloreje.
2. Përcaktimet e dokumentit “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010 do të ngelen në fuqi, për atë sa nuk bien në kundërshtim me përcaktimet e kësaj Rregulloreje dhe aktet e tjera nënligjore të AKEP, deri në datën e miratimit/hyrjes në fuqi të dokumentit të specifikimeve teknike të miratara sipas kësaj Rregulloreje
3. Sipërmarrësit dhe operatori CRDB kanë detyrim që gjatë periudhës 6 mujore të referuar në pikën 1 të këtij neni, të marrin të gjitha masat e nevojshme teknike dhe operacionale në mënyrë që në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të kenë implementuar në sistemet dhe procedurat e brendshme të tyre të gjitha ndryshimet e nevojshme për zbatimin e të gjitha përcaktimeve të kësaj Rregulloreje.

Për sa i përket krijimit të Statusit Pezull në CRDB, Operatori i CRDB ka përgatitur zgjidhjen përkatëse teknike e cila gjatë procesit të këshillimit publik do të diskutohet dhe me operatorët kryesore dhe pas miratimit të versionit final të Projekt-Rregullores do të duhet të implementohet dhe në sistemet e të gjithë operatorëve, së bashku me ndryshimet për Pranimin me Kusht të kërkesave për portim numri.

Për sa i përket trajtimit të kërkesave për portim numri të caktizuar, operatorët (në rolin e ODH) do të duhet të kryejnë ndryshimet përkatëse në databazat që komunikojnë për kërkesat për portim. Në periudhën tranzitore, AKEP propozon që ODH dhe OM mund të trajtojnë kërkesat për portim numri të çaktivizuar në mënyrë jo-automatike, nëpërmjet komunikimeve midis skudrave përkatëse të portabilitetit të OM dhe ODH.

Për sa i përket dokumentit “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010, AKEP do të kryejë ndryshimet përkatëse pas miratimit të versionit final të Projekt-Rregullores. Dokumenti i miratuar në vitin 2010 ka shërbyer kryesisht për ngritjen dhe vënien në funksionim të CRDB për herë të parë në vitin 2011. Megjithatë, AKEP vlerëson se ky dokument ka nevojë të rishikohet për të reflektuar të gjitha ndryshimet e kryera në Rregulloren e Portabilitetit në periudhën 2010-2018 (të cilat janë implementuar në mënyrë nga Operatori i CRDB dhe operatorët e komunikimeve elektronike) si dhe ndryshimet që do të kryhen pas miratimit të versionit final të Projekt-Rregullores.

Pyetje nr.18:

Cili është opinionin juaj në lidhje me afatin 6 mujor shtesë për zbatimin nga operatorët të detyrimeve në lidhje me:

- a. krijimin e statusit pezull në CRDB dhe pranimin me kusht të kërkesave për portim numri nga ODH;
- b. detyrimet e ODH për procesimin e automatizuar të kërkesave për portimin e numrave të çaktivizuar?

Pyetje nr.19:

A mendoni se AKEP duhet të përcaktojë një afat shtesë/periudhë kalimtare për zbatimin edhe të detyrimeve të tjera shtesë për ODH dhe/ose OM?

Nëse PO, për cilat Detyrime dhe cili do të ishte afati kohor i arsyeshëm për implementimin e tyre?

3. Procesi i këshillimit publik

Palët e interesuara ftohen të japin komente dhe sugjerime për pyetjet e këshillimit publik të paraqitura nga AKEP në Seksionin 2 “Ndryshimet e Projekt-Rregullores me Rregulloren nr.43/2016 dhe Pyetjet e këshillimit publik” (nën-seksionet 2.1-2.11) të kësaj Shtojce, si dhe për çdo aspekt tjetër të lidhur me Projekt-Rregulloren e portabilitetit të numrit.

Në komentet/përgjigjet e dhëna, palët rekomandohet të përfshijnë edhe argumentim për përgjigjet/komentet si dhe sugjerime për përmirësimin e dokumentit.

Procesi i këshillimit publik për dokumentin “Projekt-Rregullore për zbatimin e portabilitetit të numrit” do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP, dhe palët e interesuara mund të dërgojnë komentet me shkrim në AKEP si më poshtë:

- në formë shkresore në adresën Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë.
- në formë elektronike me email në adresën info@akep.al.